



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Kamëz

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim Financiar

Bashkia Kamëz

Tiranë, tetor 2025

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin.....	4
f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.....	5
h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore	6
I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.....	6
II. HYRJA	7
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.	8
1. Objektivat dhe qëllimi.	8
2. Identifikimi i çështjes.....	8
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	9
4. Përgjegjësitë e audituesve.	9
5. Kriteret e vlerësimit	10
6. Standardet e auditimit.....	11
7. Metodatat e auditimit	11
8. Dokumentimi i auditimit.....	12
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Kamëz”	13
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	14
2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.....	14
2.2. Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore	27
2.3. Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	51
IV. REKOMANDIME	74-Error! Bookmark not defined.

Lista e shkurttimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
IT	Teknologjia e Infomacionit
NJA	Njësi Administrative

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vijim KLSH) ushtron auditim financiar në Bashkinë Kamëz, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar.

Bashkia Kamëz, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Kamëz për periudhën e aktivitetit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqënies së qytetarëve.

a. Për vitin 2024 nga Bashkia Kamëz janë shpenzuar gjithsej 4,391,646 mijë lekë nga të cilat: shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 937,783 mijë lekë; për shpenzime operative në vlerën 370,542 mijë lekë; për investime në vlerën 2,173,275 mijë lekë.

b. Për vitin 2024 Bashkia Kamëz nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithsej vlerën 2,517,725 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”.

Auditimi i këtij institucioni merr rëndësi për arsye se administron, menaxhon dhe shpenzon fonde të miratuar nga Këshilli Bashkiak Kamëz, me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimet e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve për periudhën 01.01.2024-31.12.2024.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;
- Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
- Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 90,732 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se Bashkia Kamëz për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 6 gjetje dhe ka dhënë 6 rekomandime të cilat i përkasin kategorisë masa organizative.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

-Nga auditimi i regjistrit të aktiveve, u konstatua se zëri “Pyje” në vlerën 255,881 mijë lekë dhe kullota në vlerën 201 mijë lekë janë klasifikuar në llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” dhe jo në llogarinë 211 “Pyje, Plantacione”.

-Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura konstatohet se, në fund të vitit 2023 kanë qenë në vlerën totale prej 137,905 mijë lekë, gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime në vlerën 25,046 mijë lekë dhe janë shlyer detyrime në vlerën 91,125 mijë lekë, duke rezultuar në fund të vitit 2024 një vlerë e detyrimeve të prapambetura prej 71,826 mijë lekë. Kjo vlerë përbëhet nga detyrime për investime në vlerën 37,826 mijë lekë dhe detyrime të tjera në vlerën 34,000 mijë lekë, që përfshin pagesa periodike sipas nenit 16 të kontratës së koncensionarit për pastrimin e qytetit (Eco Cleaning). Nga detyrimet për investime vlera e mbetur pa likuiduar rezultoi 6,735 mijë lekë.

- Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, më datë 01.01.2024 rezulton në vlerën 801,471 mijë lekë dhe mbyllje të vitit ushtrimor 2024 rezulton në vlerën 867,476 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 ka pasur rritje në vlerën 66,005 mijë lekë, e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset, taksa e tarifa vendore familjarët, legalizime, gjoba IMTV sipas akt akordimit midis Sektorit të Taksave dhe Drejtorisë së Financës. Peshën më të lartë të detyrimeve e përbëjnë

detyrimet nga legalizimet në vlerën 336,640 mijë lekë ose në masën 38.8% e totalit të detyrimeve; Në lidhje me debitorët e taksave, rezulton se ka një rritje të debitorëve nga viti 2023 në shumën 58,495 mijë lekë nga taksat dhe tarifat vendore çka tregon një performancë të ulët në garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara të mëparshme.

-Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, u konstatua se për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore rezulton në vlerën 2,889,983 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 2,517,725 mijë lekë ose në masën 87% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 372,258 mijë lekë. Treguesi i realizimit të të ardhurave është pozitiv në përgjithësi megjithatë disa taksa kanë realizim të dobët si: Taksa për hapësira publike 9.8%; Tarifë legalizimi 0.8%; Tarifë leje transporti 62.6%; Të ardhura të tjera 52.2%. Ndërkohë disa tarifa e tejkalojnë planin si: 3% nga kontributi i subjekteve private sipas ligjit për strehimin 693.5%; Shitje pasurie dhe privatizim banese 225%; Taksë tabelë 156.8%; Kjo tregon se planifikimi i të ardhurave ka nevojë për përmirësim, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Drejtoria e Financës dhe e Kontabilitetit të marrë masa për klasifikimin e drejtë të aktiveve dhe kontabilizimin e tyre në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”.

- Drejtoria e Financës dhe e Kontabilitetit të marrë masat për krijimin e një plani të qëndrueshme për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, duke u mbështetur në priorizimin e pagesave sipas ndikimit në shërbimet publike.

- Bashkia Kamëz në bashkëpunim me strukturat që në aktivitetin e tyre sigurojnë të ardhura tatimore dhe jo tatimore të analizojnë situatën debitore dhe të hartojnë një plan masash periodik dhe vjetor:

- Për të siguruar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore brenda afateve të miratuar me VKB, me qëllim parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj;

- Për rritjen e arkëtimeve nga ana e debitorëve me qëllim minimizimin e vlerës progresive të debisë prej 867,476 mijë lekë.

- Bashkia Kamëz të marrë masat për planifikimin e të ardhurave nga burimet e veta, për të siguruar që planifikimi të jetë realist dhe në përputhje me tendencat aktuale të mbledhjes, duke shmangur mbivlerësimet apo nënvlerësimet që çojnë në devijime të theksuara.

Planifikimi të kryhet duke u bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2024:

a. Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes¹

¹ Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar“, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.54), Kapitulli VII pika 4.1. Një opinion me “Theksim Çështjeje”, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare por që nuk janë thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare të Bashkisë Kamëz për vitin ushtrimor 2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese, si dhe të gjitha pasqyrat statistikore që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare të Bashkisë Kamëz paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në datën 31.12.2024, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, shprehur në bazën e opinionit, të cilat në gjykimin e audituesit të pavarur justifikojnë dhënien e një **opinionit të pamodifikuar me theksim të çështjes**.

Baza për opinion mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi kryer auditimin financiar në mbështetje me Ligjin Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s) mbështetur në ISSAI 200 “Parimet e auditimit financiar”, ISSAI 2000 “Aplikimi i standardeve të auditimit financiar”, në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, të miratuar me Vendimin Nr. 246, datë 29.12.2022 të Kryetarit të KLSH, si dhe ISSAI 130- Kodi i Etikës. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 217 , datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, si dhe kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për sa më poshtë:

- Nga auditimi i regjistrave të aktiveve u konstatua se zëri “Pyje” në vlerën 255,881 mijë lekë dhe kullota në vlerën 201 mijë lekë janë klasifikuar në llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” dhe jo në llogarinë 211 “Pyje, Plantacione”.

- Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, më datë 01.01.2024 rezulton në vlerën 801,471 mijë lekë dhe mbyllje të vitit ushtrimor 2024 rezulton në vlerën 867,476 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 ka pasur rritje në vlerën 66,005 mijë lekë, e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset, taksa e tarifa vendore familjarët, legalizime, gjoba IMTV sipas akt akordimit midis Sektorit të Taksave dhe Drejtorisë së Financës. Peshën më të lartë të detyrimeve e përbëjnë detyrimet nga legalizimet në vlerën 336,640 mijë lekë ose në masën 38.8% e totalit të detyrimeve; Në lidhje me debitorët e taksave, rezulton se ka një rritje të debitorëve nga viti 2023 në shumën 58,495 mijë lekë nga taksat dhe tarifat vendore çka tregon një performancë të ulët në garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara të mëparshme.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 738/1 prot., datë 03.07.2025 “Auditim financiar në Bashkinë Kamëz”, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.07.2025- 31.07.2025, në subjektin Bashkia Kamëz për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 - 31.12.2024, u krye “Auditim Financiar” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. M. V, *Përgjegjës Grupi*,
2. K. F. *Anëtar*;
3. B. P. *Anëtar*;
4. A. G. *Anëtar*;
5. K. G. *Anëtar*;

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t'i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Kamëz.

2. Identifikimi i çështjes.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kamëz, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Kamëz.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Kryetari i Bashkisë Kamëz (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Kamëz, bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar në aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.²

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Kamëz në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAL, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Kamëz është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

² Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 15

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”;
- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 7, datë 28.02.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “*Për përgatitjen e buxhetit vendor*”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar;
- Në fushën e mbajtjes së Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar;
- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në RSH*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “*Për sistemin e taksave lokale*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “*Për taksat kombëtare*”, i ndryshuar; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.09.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.
- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “*Për pagat e vetëqeverisjes Vendore*”, i ndryshuar.
- Në fushën e administrimit e pronës publike: Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*”, VKM nr. 433, datë 08.06.2016

“Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave të Bashkisë”.

6. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Kamëz grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 *“Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”*, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 *“Udhëzues të Auditimit Financiar”*; ISSAI 2300 *“Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”*; INTOSAI GOV 9100 *“Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”* si dhe INTOSAI GOV 9110 *“Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”*; INTOSAI *“Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”* etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodatat e auditimit

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*³. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara

³ ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura lehtë, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e raportit Përfundimtar të Auditimit.

Me shkresën nr. 738/3, datë 11.09.2025, nga grupi i auditimit të KLSH është nisur Projektraporti i Auditimit në të cilën u evidentuan mangësitë e konstatuara gjatë procesit të auditimit, mangësi të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjor gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i përcillet subjektit për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

Nga ana e Bashkisë Kamëz janë paraqitur kundërshtimet me shkresën nr. 8726 prot., datë

09.10.2025 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 738/4 datë 09.10.2025 në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit. Pas shqyrtimit të kundërshtimeve të subjektit është vijuar me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Kamëz”

a. Bashkia Kamëz është njësi vendore institucion i pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe katër ish-komunave. Bashkia Kamëz ndodhet 7 km larg kryeqytetit. Kufizohet nga veriu me Bashkinë Krujë, nga jugu dhe lindja me Bashkinë Tiranë dhe nga perëndimi me Bashkinë Vorë. Terreni në përgjithësi është i sheshtë, me një pjerrësi të lehtë drejt veriperëndimit. Zona ndodhet në një kuotë që varion nga 80-90 m mbi nivelin e detit në pjesën jugore, që zbrit në 45 m mbi nivelin e detit, pranë aeroportit të Rinasit në pjesën veriore. Përshkohet nga rruga kombëtare që lidh kryeqytetin me veriun e vendit. Bashkia Kamëz ndodhet në trekëndëshin strategjik: kryeqyteti Tiranë - aeroporti i Rinasit - porti i Durrësit. Kamza ka një sipërfaqe prej 37.18 km², popullsia është 96,137 banorë dhe ka dy njësi administrative: Bashkia Kamëz pas ndarjes së re territoriale përfshin nën administrimin e saj edhe njësinë administrative Paskuqan. Misioni i Bashkisë Kamëz është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim. Buxheti i Bashkisë Kamëz si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara.

Bashkia siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë;

b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;

c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;

ç) ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;

d) realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;

dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;

e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Kamëz, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Kamëz për periudhën e aktivitetit të vitit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe

llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zbatimin e kuadrit rregullator ligjor të raportimit financiar.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i Etikës;
3. Struktura organike e institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjia dhe Regjistri i Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësi i Vetëvlerësimit dhe dërgimi në Ministrinë e Financave.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2024, u konstatua se:

I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1: “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.

-Nga auditimi i përgjigjeve të dhëna në pyetësin e vetëvlerësimit si dhe dokumentacionit justifikues mbi të dhënat e paraqitura në pyetësor, konstatohet se institucioni vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me Vendimin nr. 296 prot., datë 28.03.2024 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të Bashkisë Kamëz”. Në rregullore janë përcaktuar parimet, prioritetet, marrëdhënia ndërmjet strukturave, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.

-Kodi i Etikës është miratuar me Vendimin nr. 225 prot., datë 27.03.2023, në mbështetje të Ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” dhe Ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se ka programe të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.

-Me shkresën nr. 154 prot., datë 11.01.2019 është miratuar “Rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashkinë Kamëz” dhe “Rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Kamëz”. Me

shkresën nr. 51/1 prot. datë 07.01.2025 është raportuar në ILDKPKI për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

-Njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore, bashkëpunon me zyrtarët raportues dhe zyrtarin autorizues në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil.

-Bëhen dy vlerësime gjatë vitit kalendarik, vetëm për nëpunësit civil në periudhë prove vlerësimi është një vjeçar në përfundim të periudhës së provës, ndërsa për punonjësit me kod pune kyhet vlerësim 1-vjeçar.

-Ankesat nga jashtë depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun), duke iu adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të cilat trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën.

Parimi 2: “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”

-Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësive publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Për vitin 2024, situata paraqitet efektive dhe ka raportimeve të rregullta periodike nga të gjitha drejtoritë, raportim i cili është i përqendruar përveç çështjeve financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva.

-Bashkia Kamëz ka hartuar raporte monitorimi periodike dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si edhe në Ministrinë e Financave (MF). Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se për vitin 2024, Bashkia Kamëz ka hartuar Planin e Veprimit të Kontrollit të Brendshëm në përputhje me paragrafin 3.3 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.

-Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisjes bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë.

Parimi 3: “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësive (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiave funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësive publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësive.

Institucioni vepron mbi bazën e rregullores së brendshme të miratuar me Vendimin me aktin nr. 296 prot. datë. 28.03.2024. “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të Bashkisë Kamëz” e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive, të publikuara në faqen zyrtare të bashkisë.

Bazuar në ndryshimet në strukturën organizative është bërë ndryshimi i rregullores me aktin nr. 985 prot. datë 21.10.2024 “Për ndryshimin e Vendimit nr. 296 datë 28.03.2024”.

Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit, si pjesë e rregullores së brendshme.

-Bashkia Kamëz ka të hartuar dhe miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor me VKB nr. 86 datë 14.07.2022 dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 01 datë 27.07.2022.

-Me Vendimin nr. 27 datë 17.01.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz për vitin 2024” (i ndryshuar me Vendimin nr. 230 datë 04.03.2024, Vendimin nr. 698 datë 10.07.2024, me Vendimin nr. 951 datë 14.10.2024) Vendim nr. 127 datë 05.01.2024 (i ndryshuar me Vendimin nr. 8002 datë 26.09.2024, Vendimin nr. 8896 datë 23.10.2024), është miratuar struktura e përbërë nga 1056 punonjës (ku përfshihen punonjësit e bashkisë dhe punonjësit nga transfertat sektoriale), ndër të cilat 116 nëpunës civilë.

-Struktura organizative e Bashkisë

Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë (jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:

Funksionet politike: Kryetari; Zëvendëskryetarët; Administratorët; Kabineti. Emërimi dhe lirimi i funksionarëve politikë dhe funksionarëve të kabinetit të Bashkisë bëhet me Urdhër të Kryetarit.

Nëpunësit civilë: Shërbimi Civil në Bashki organizohet dhe funksionon sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke përcaktuar skemën e administrimit të këtij shërbimi. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:

a. Nëpunës të nivelit të mesëm drejtues: - Drejtorë Drejtorie

b. Nëpunës të nivelit të ulët drejtues: - Përgjegjës Sektori

c. Nëpunës të nivelit ekzekutiv: - Specialistët.

Punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë.

Struktura e Bashkisë Kamëz për vitin 2024 (pa përfshire punonjësit që paguhën nga transfertat sektoriale)

Tabela nr.1: Struktura e Bashkisë Kamëz

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	1017	Nëpunës Civilë	108
		Nëpunës me kontratë	909
Numri i të punësuarve me kontratë provizore (punonjës zëvendësues)		-	7
Vende vakante		-	39

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Përgjatë vitit 2024, janë rekrutuar 250 punonjës të rinj dhe janë larguar 80 punonjës të Bashkisë (punonjës të Bashkisë dhe nga transfertat sektoriale). Në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës dhe vlerësimet për çdo punonjës.

Bashkia Kamëz ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

-Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiave funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

-Dokumenti përfundimtar i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024-2026 është miratuar nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Kamëz me Vendimin nr. 103, të datës 18.12.2023.

-Nga auditimi rezulton se lidhur me strukturën organizative, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Kamëz ka miratuar strukturën organizative për vitin 2024 me aktin nr. 27, datë 17.01.2024.

Bashkia Kamëz ka miratuar:

- Planin 5-vjeçar për strehimin social me VKB nr. 159 datë 21.12.2022,
- Planin Social 2024 - 2026 me Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.10 datë 22.01.2024,
- Planin e arsimit parashkollor në dhjetor 2024,
- Planin e përgjithshëm vendor me VKB nr. 86 datë 14.07.2022 dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 01 datë 27.07.2022.

-Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konstatohet se janë organizuar takime me drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve, si dhe janë organizuar takime me palët e treta si me grupet e interesit nëpërmjet dëgjësave me publikun.

Parimi 4: “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

-Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve të detyrueshëm ofruar nga ASPA pjesë e procedurës për përfitim të statusit të nëpunësit civil. Nga auditimi rezultoi se nga Bashkia Kamëz, konkretisht struktura përgjegjëse e saj, Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka hartuar plane vjetore trajnimesh të detyrueshme për punonjësit e saj. Në materialet dërguar gupit të auditimit të KLSH konstatohen dokumente që vërtetojnë trajnimin e punonjësve nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, ndërkaq Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1 parashikon se vetë institucioni duhet të organizojë trajnime të brendshme për stafin.

-Trajnimet realizohen nga ASPA dhe punonjësit i për zgjedhin vetë temat për të cilat kanë interes. Hartimi i planeve vjetore të trajnimeve mundëson një trajnim efektiv të personelit në përputhje me pozicionin në strukturë. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësive kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.

-Për Bashkinë Kamëz, Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

-Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Financës.

-Me Urdhrin nr. 81 datë 25.01.2024, titullari ka emëruar në rolin e Koordinatorës së MFK, znj. R. N. me detyrë zv/kryetare e Bashkisë. Me urdher nr. 723 prot. datë 19.07.2024, titullari ka emëruar në rolin e Koordinatorës së MFK, znj. M. H. me detyrë zv/kryetare e Bashkisë.

-Me Urdhrin nr. 82 datë 25.01.2024, titullari i Bashkisë Kamëz ka krijuar ekipin e koordinatorëve të riskut për çdo nivel drejtimi.

-Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).

Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 2101 datë 11.03.2024 është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se në vitin 2024 janë mbajtur 4 takime (datë 29.03.2024, 02.05.2024, 10.10.2024, 18.11.2024), sipas parashikimeve ligjore. Veprime këto në përputhje me Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualin për MFK”. Vendimet e Grupit janë marrë në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit janë pasqyruar në dokumente dhe i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”, në përputhje me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, 12 dhe 27; “Manuali MFK” Kreu II kap. 2.2.6.

Parimi 5: “Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësisë dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

Nga auditimi i kryer rezulton se Bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme. Njësia publike ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë dhe ka autorizime për delegimin e detyrave.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

Për vitin 2024, me urdhrin nr. 2101 prot., datë 11.03.2024, “*Për ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027*”. Në këtë urdhër, komisioni ka në përbërje 27 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Parimi 6: “Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre”

-Nga Bashkia Kamëz përcaktohen objektiva sasior.

-Nga auditimi i të dhënave, duke marrë në konsideratë se Bashkia duhet të specifikojë dokumentet e planifikimit, njësia ka përgatitur PBA, në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin.

Parimi 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

-Nga Bashkia Kamëz është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut, me aktin nr. 2096 prot. datë 11.03.2024 në përputhje me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” dhe “*Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit*”, si dhe Udhëzimi nr.16 dt. 20.07.2016.

-Me Vendimin nr. 2096 prot. datë 11.03.2024 “*Mbi miratimin e strategjisë së riskut*” Kryetari i Bashkisë Kamëz ka miratuar strategjinë e riskut.

-Me Vendimin nr. 190 prot. datë 22.02.2024 Kryetari i Bashkisë Kamëz ka miratuar regjistrin e riskut.

-Nga auditimi rezulton se, gjurmët standarde të auditimit janë miratuar me Vendimin nr. 189 prot. të datës 21.02.2024.

Parimi 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”

-Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

-Nga auditimi evidentohet se Bashkia Kamëz vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Ka sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”

-Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

-Bashkia Kamëz ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore

apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualët e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

III. Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”

Parimi 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivite kontrolli”

-Nga të dhënat e vëna në dispozicion, konstatohet setë gjitha drejtoritë e Bashkisë kanë hartë dhe manual të proceseve të punës. Manuali i proceseve të punës është miratuar nga kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 189 prot., datë 21.02.2024, harta e proceseve të punës miratuar me shkresën nr. 189/1 prot., datë 21.02.2024.

-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

-Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person. Detyrat janë të ndara. Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Përgjegjësi i Buxhetit. Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga specialisti i financës për kontabilizimin dhe autorizimi i pagesës nga drejtori i financës.

-Në zbatim të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Bashkia i ka të qarta procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj.. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim).

-Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP.... dhe krijimi i tyre në sistemin e PP” është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.

-Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AFMIS i përdorur për pagesat, i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit.

-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyra dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Kamëz.

-Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrollin e angazhimeve, menaxhimin e investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Parimi 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivite të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”

-Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo

organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

-Bashkia Kamëz ka një server për menaxhimin e sistemit të taksave të shtrirë edhe në Njësitë Administrative. Ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it, procedurë që e realizojnë nëpërmjet prokurimit të shërbimit me kontratë me kompaninë Besimes InforM on Systems Software. Institucioni përdor edhe sisteme të tjera të It-së si E-Lejet, sistemin e pagesave me thesarin, sistemin e strehimit.

Me aktin nr. 6465 prot., datë 01.09.2023 është miratuar rregullore për sigurinë e informacionit.

-Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces.

Parimi 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

-Bashkia i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.

-Me Vendimin nr. 36 datë 20.03.2020, Bashkia ka miratuar rregulloren “Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve, inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, dhe strategjinë e menaxhimit të riskut të aktiveve në Bashkinë Kamëz.”

-Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë së Financës.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Parimi 13: “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”

-Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit, për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

-Drejtoria e Financës në Bashkinë Kamëz nuk ka një program financiar për mbajtjen e kontabilitetit por operon me paketën Office për kryerjen e veprimeve kontabël.

-Institucioni ka dhe sisteme të tjera të IT-së E-Lejet, Tais, Sistemin e pagesave me thesarin dhe instrumentin e planifikimit financiar. Është miratuar rregullore e brendshme e IT me aktin nr. 6465 dt. 01.09.2023. Masat të cilat janë marrë janë ngritja e firewall ndryshimet e passwordeve në mënyrë periodike në aksesin e pajisjeve kritike IT (Modem, Ruter, Swith servera etj.)

-Për sa i përket rregullave për ruajtjen nga dëmtimet fizike janë të përcaktuara në rregullat dhe përcaktimet teknike të servisit dhe IT.

-Institucioni ka një sistem reserve të përshtatshëm, plan rikuperimi nga fatkeqësitë.

Parimi 14: “Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor”

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Nga auditimi konstatohet se Bashkia i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

-Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit, për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

-Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e Bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, proces verbalet e mbledhjeve u komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare.

-Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e Bashkisë.

-Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15: “Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm”

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresor apo në rrugë elektronike nëpërmjet aksesit në adresat zyrtare të e-mailit.

-Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit.

-Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Parimi 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

-Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë janë hartuar manuallet e proceseve të punës, ku janë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

-Raportohet mbi baza periodike pranë MF dhe GMS për veprimtarinë financiare referuar parashikimeve të PBA-së.

-Bashkia Kamëz monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar me shkresën nr. 1982 prot., datë 27.02.2025 në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MF.

- Bashkia Kamëz ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit.
- Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.
- NJAB ka hartuar planin strategjik të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2024.

Parimi 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

-Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

-Nga auditimi u konstatua se, ka drejtori (Lagje Bathore, Lagje nr. 1, Lagje nr. 2) që kanë hartuar dokumentat bazuar në manualin e MFK i miratuar me UMF nr. 108 datë 17.11.2016. Ky urdhër është shfuqizuar me urdhrin nr. 4 datë 26.01.2024, “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, i cili është botuar në fletoren zyrtare nr. 38 datë 27.02.2024. Me miratimin e manualit të ri ka ndryshime në anekset e MFK. Hartimi i anekseve nga të gjitha drejtoritë duhet të bëhet bazuar në urdhrin nr. 4 datë 26.01.2024, i cili parashikon dokumenta si: Aneksi 4. Regjistri i riskut dhe matrica e riskut, Aneksi 5. Plani i menaxhimit të riskut, Aneksi 7: Plani i masave të trajtimit të risqeve për institucionin. Disa prej dokumentave të MFK për vitin 2024 janë hartuar përpara publikimit të manualit të MFK (urdhër nr. 4 date 26.01.2024, “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, i cili është botuar në fletoren zyrtare nr. 38 datë 27.02.2024.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. R. B., Drejtori i Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në cilësinë e koordinatorit të MFK
2. Znj. R. H., Drejtor i Burimeve Njerëzore.

Auditi i Brendshëm

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë së AB të Bashkisë Kamëz;
2. Planet strategjike dhe vjetore, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Plani i auditimeve të brendshme për vitin 2024;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Projekt-raportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike;
7. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Kamëz, për vitin 2024, funksionon në nivel drejtorie, sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr.103 datë 18.12.2023 “Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2024- 2026” si dhe vendimit të Kryetarit

të Bashkisë nr. 27 prot., datë 17.01.2024. Për sa më sipër është vepruar në përputhje me legjislacionin e brendshëm, si dhe në përputhje me Standardin Atributiv nr. 1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Për vitin 2024, kjo Drejtori ka funksionuar me 5 punonjës në strukturë.

Tabela nr. 2. Struktura e Drejtorisë së AB për vitin 2024

Nr.	2024	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijeshme
1	B. D.	Drejtor	I lartë	28	20	2008	Po
2	R. M.	Specialist	I lartë	35	16	2011	Po
3	V. A.	Specialist	I lartë	5	2		Po
4	A. D.	Specialist	I lartë	5	2	2023	Po
5	M. K.	Specialist	I lartë	5	1		Po

Burimi: Bashkia Kamëz

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për periudhën 2024

Përgjatë periudhës janar - dhjetor 2024, nga DAB pranë Bashkisë Kamëz, janë kryer 8 auditime, miratuar me planin vjetor të punës me aktin nr.7864 prot., datë 18.10.2023 i ndryshuar.

Tabela nr. 3. Llojet e Auditimeve

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financ	Kombi	Performace	Të tjera
2	Viti 2024	9	8	1	2	6	-	-

Burimi: Bashkia Kamëz

Plani Strategjik 2024-2026 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2024, është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, me shkresën nr.7864/1 datë 18.10.2023.

Për aktivitetin e veprimtarisë së Strukturës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, me shkresën nr. 1421 datë 07.02.2025.

-Karta e auditimit të brendshëm është përgatitur dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Kamëz me shkresë nr. 8823 prot., datë 30.09.2022.

-Nga auditimi i raportimit për vitin 2024, rezulton se janë dhënë 37 rekomandime, nga të cilat janë pranuar të gjitha. Nga 37 rekomandime janë zbatuar 28 rekomandime, ndërkohë janë në proces zbatimi 9 rekomandime. Në mënyrë të përmblodhur paraqiten në tabelë si vijon:

Tabela nr. 4. Realizimi i planit të angazhimeve për vitin 2024

Nr.	Subjekte të audituara nga NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të përcaktuara	Angazhime të kryera	Angazhime në proces
			A. të përputhshme risë	A. të performancës	A. financiare	A. informacionit	A. të kombinuara				
a.	1	(3.1+3.2+3.3+3.4+3.5+3.6+3.7) ose (4.1+4.2)	3.1	3.2	3.3	3.4	3.5	3.6	3.7	4.1	4.2
1.	Drejtoria e Planifikimit e Zhvillimit të Territorit	1			1						1

2.	Drejtoria Juridike e Prokurimeve Publike	1					1			1	
3.	Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit	1					1			1	
4.	Drejtoria e Integritetit të BE-së dhe Projekteve të Huaja	1					1			1	
5.	Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit (IMT)	1			1					1	
6.	Drejtoria e Financës & Kontabilitetit	1					1			1	
7.	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	1					1			1	
8.	Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit	1					1			1	
9.	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve 2023	1	1							1	
Totali		9	1	0	2	0	6	0	0	8	1

Burimi: DAB, Përpunuar nga grupi i Këshill-së

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Me Vendimin nr. 8823, datë 30.09.2022, Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. R. S. ka miratuar Kartën e Auditimit të Brendshëm për Bashkinë Kamëz. Karta e Auditimit të Brendshëm është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm (MAB), miratuar me Urdhërin nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”;

-Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe është hartuar në përputhje me standardet e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe aneksin me modelin përkatës në fundin e kapitullit III;

-Plani vjetor i auditimeve për vitin 2024 është përgatitur në mënyrë të rregullt, në përputhje me paragrafin 3.2 të Kapitullit III të MAB, si dhe me modelet përkatëse në po këtë kapitull;

-Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2024, ka qenë në përputhje me urdhrin nr. 4 dt. 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Për vitin 2024, konstatohet se janë planifikuar 9 auditime, janë realizuar 8 auditime është në proces 1 auditim: Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike, Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtoria e Integritetit të BE-së dhe Projekteve të Huaja, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), Drejtoria e Financës & Kontabilitetit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit, Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të vitit 2023.

-Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit, veprime të cilat përputhen me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të kapitullit VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” të MAB , miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016.

U audituan (me zgjedhje) tre dosje auditimi (Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit), ku rezultoi se në dosje ishte dokumentacioni:

1. Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit

- Autorizimi për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit nr. 2906/1 prot. datë 11.04.2024;

- Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit nr. 2906 prot. datë 11.04.2024;

- Takimi fillestar për fillimin e misionit të auditimit datë 21.04.2024;

- Deklarata e konfliktit të interesit datë 11.04.2024;

- Programi i angazhimit të auditimit nr. 2906/2 prot. datë 22.04.2024;
- Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit;
- Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesi;
- Projekt Raporti i auditimit nr. 2906/3 prot. datë 10.07.2024;
- Raporti Përfundimtar i auditimit nr. 2906/4 prot. datë 31.07.2024;
- Memo (përmbledhja e shkurtër përfundimtare) e cila i është paraqitur titullarit të Institucionit nr. 2906/5 prot. datë 01.08.2024;
- Monitorimi i brendshëm i aktivitetit të auditimit të brendshëm nga çdo auditues datë 01.08.2025;
- Kontrolli i vlerësimit të cilësisë për monitorimin e brendshëm për çdo auditim;
- Reagimet (feedback) e auditimit datë 01.08.2024;
- Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar datë 12.04.2024;

2. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

- Autorizimi për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit nr. 8272/1 prot. datë 04.10.2024;
- Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit nr. 8272 prot. datë 04.10.2024;
- Takimi fillestar për fillimin e misionit të auditimit datë 15.10.2024;
- Deklarata e konfliktit të interesit datë 04.10.2024;
- Programi i angazhimit të auditimit nr. 8272/2 prot. datë 15.10.2024;
- Dokumentat që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit;
- Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesi;
- Projekt Raporti i auditimit nr. 8272/3 prot. datë 15.12.2024;
- Raporti Përfundimtar i auditimit nr. 8272/4 prot. datë 22.12.2024;
- Memo (përmbledhja e shkurtër përfundimtare) e cila i është paraqitur titullarit të Institucionit nr. 8272/5 prot. datë 23.12.2024,
- Monitorimi i brendshëm i aktivitetit të auditimit të brendshëm nga çdo auditues datë 27.12.2024;
- Kontrolli i vlerësimit të cilësisë për monitorimin e brendshëm për çdo auditim;
- Reagimet (feedback) e auditimit datë 27.12.2024;
- Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar datë 06.02.2025;

3. Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit

- Autorizimi për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit nr. 6392/2 prot. datë 26.07.2024;
- Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit nr. 6392/1 prot. datë 26.07.2024;
- Takimi fillestar për fillimin e misionit të auditimit datë 12.08.2024;
- Deklarata e konfliktit të interesit datë 26.07.2024;
- Programi i angazhimit të auditimit nr. 6392/3 prot. datë 12.08.2024;
- Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit;
- Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesi;
- Projekt Raporti i auditimit nr. 6392/4 prot. datë 22.10.2024;
- Raporti Përfundimtar i auditimit nr. 6392/5 prot. datë 31.10.2024;
- Memo (përmbledhja e shkurtër përfundimtare) e cila i është paraqitur titullarit të Institucionit nr. 6392/6 prot., datë 05.11.2024;
- Monitorimi i brendshëm i aktivitetit të auditimit të brendshëm nga çdo auditues dhe nga drejtuesi datë 14.11.2024;
- Kontrolli i vlerësimit të cilësisë për monitorimin e brendshëm për çdo auditim;
- Reagimet (feedback) e auditimit datë 14.11.2024;
- Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar datë 13.12.2025;

Për vitin 2024 janë rekomanduar gjithsej 37 rekomandime si më poshtë:

Në subjektin “Drejtoria e Financës & Kontabilitetit”, 4 rekomandime;

Në subjektin “Ndërmarrja e Pastrim Gjellbërimit”, 8 rekomandime;

Në subjektin “Drejtoria e Çështjeve Ligjore & Prokurimit Publik”, 7 rekomandime;

Në subjektin “Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit”, 5 rekomandime;

Në subjektin “Drejtoria e Integritetit në BE dhe Projekteve të Huaja”, 1 rekomandim;

Në subjektin “Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore”, 9 rekomandime;

Në subjektin “Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit”, 3 rekomandime;

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna është rreth 75 %, por procesi i zbatimit të tyre vazhdon të ndiqet si nga vetë subjektet ashtu dhe nga DAB.

- Është realizuar auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e vitit 2023, kjo sipas programit të angazhimit me nr. 1750/1 prot, datë 29.02.2024. Ky auditim ka përfunduar dhe është dërguar raporti me shkresën nr. 1750/2 prot., datë 29.03.2024. Bazuar në UMF nr. 42 datë 27.10.2020, “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, janë hartuar dokumentet standarde për auditimet për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve si,

a. Program i angazhimit të auditimit të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve;

b. Autorizim për kryerjen e auditimit për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve;

c. Formulari përmbledhës për zbatimin e rekomandimeve, për secilin subjekt;

d. Raport Vjetor i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve .

Raportimi i zbatimit të rekomandimeve i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 2758 prot, datë 08.04.2024.

Vlerësimi i dokumentimit të punës audituese

Nga njësia e AB të Bashkisë, është plotësuar inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit, si dhe dosjet e përhershme për të gjitha subjektet që auditohet nga kjo njësi, ku janë plotësuar me dokumentacionin përkatës, kjo sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapit. VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, formati 1 “Inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit” si dhe pikës 6.3 “Dosja e përhershme”.

Nga ekzaminimi i dokumentacionit, u vu re se të gjithë dosjet e evaduar janë arkivuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” dhe në zbatim të tij “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor të Republikës së Shqipërisë”. Dosjet e auditimit vlerësohen të plotësuara sipas kërkesave të manualit dhe të gatshme për arkivim.

Mbi veprimtarinë e Komitetit të Auditimit të Brendshëm

-Bashkia Kamëz ka ngritur Komitetin e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar. Nga materialet e vëna në dispozicion, raporti dërguar Kryetarit të Bashkisë Kamëz, z. R. S. dhe procesverbalet e mbledhjeve të zhvilluar nga ky organ, rezulton se përbërja dhe veprimtaria e Komitetit të Auditimit të Brendshëm ka qenë në përputhje me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” si dhe me VKM nr. 160/2016, “Për mënyrat e Funksionimit, Kompetencat dhe Përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.”

Komiteti i Auditimit të Brendshëm i ngritur me aktin nr. 527 prot, datë 24.06.2022 “Për ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kamëz”, rikonfirmuar me aktin nr. 5230 prot, datë 21.06.2024, gjatë vitit 2024 ka zhvilluar 6 (gjashtë) mbledhje dhe ka marrë 6 (gjashtë) vendime, konkretisht:

-Vendimi nr. 1, datë 20.01.2024, “Për miratimin e kalendarit të mbledhjeve të KAB për vitin 2024”;

-Vendimi nr. 2, datë 24.01.2024, “Dhënie mendimi dhe rekomandimi pozitiv për raportin vjetor 2023 të veprimtarisë së NJAB”;

-Vendimi nr. 3, datë 08.04.2024, “Dhënie vlerësimi për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në përfundim të angazhimit të auditimit, tek njesitë publike të audituara”;

-Vendimi nr. 4, datë 14.10.2024 “Për miratimin e kalendarit të mbledhjeve të KAB për periudhën tetor - dhjetor 2024”;

-Vendimi nr. 5, datë 15.10.2024, “Vlerësim dhe rekomandim për ndryshimin e planit vjetor të angazhimeve për vitin 2024”;

-Vendimi nr. 6, datë 15.10.2024, “Vlerësim dhe mendim pozitiv për planin strategjik 2025 - 2027 dhe planin vjetor 2025, të Auditimit të Brendshëm”;

Sa më sipër, Dokumentet e auditimit janë hartuar në përputhje me standardet dhe përcaktimet e Manualit të Auditit të Brendshëm.

Në lidhje me këtë drejtim të auditimit, nuk janë paraqitur pretendime/observacione nga subjekti i audituar Bashkia Kamëz, për Projektraportin e auditimit të dërguar me shkresën nr. 738/3 prot., datë 11.09.2025.

2.2. Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore

-Auditimi i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar, shënimeve shpjeguese dhe pasqyrat statistikore.

-Auditimi i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme.

-Auditimi i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta/transfertat dhe mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare;
- Ditarët e kontabilitetit;
- Listë pagesat me zgjedhje;
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për periudhën raportuese ushtrimore të vitit 2024;
- Akt-rakordimet e kryera me degën e thesarit Tiranë për periudhën raportuese të vitit 2024;
- Dokumentet e inventarizimit fizik të AAGJM, etj, për periudhën raportuese ushtrimore viti 2024

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

• Mbatja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2024

Në fund të periudhës ushtrimore, bilanci është plotësuar sipas formateve standarde të miratuara me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Pasqyrat financiare të vitit 2024 janë përgatitur nga drejtori i financës znj. V. S. në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe janë konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. R. S. në cilësinë e

Nëpunësit Autorizues, si dhe janë depozituar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 2822 datën 27.03.2025, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

Janë mbajtur rregullisht ditarët e arkës, bankës, magazinës dhe veprimeve të ndryshme. Janë mbajtur dhe përditësuar rregullisht ditarët analitikë të të gjitha llogarive, përfshirë llogaritë inventariale të magazinës, për të cilat është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Janë përgatitur formatet e mëposhtëm:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

• **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Kamëz për vitin 2024 janë të nënshkruara nga z. R. S. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. V. S. me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, si dhe janë depozituar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 2822 në datën 27.03.2025, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

• **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditarit i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

• **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe siguri i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare, por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhornimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave.

Është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentacionit bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- **Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Kamëz për aktivitetin ekonomik-financiar për periudhën 01.01.2024 deri më datën 31.12.2024. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024

Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Kamëz në 31.12.2024, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar tre pjesët përbërëse të saj paraqiten si më poshtë:

a- Të drejtat (Aktivet)	20,662,392 mijë lekë
b- <u>Detyrimet (Pasivet)</u>	<u>1,312,615 mijë lekë</u>
c- Fondet Neto (Aktivet neto)	19,349,777 mijë lekë

Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive-Pasive= Aktive Neto 19,349,777 mijë lekë.

1.1. Të Drejtat (Aktivet).

Aktivet më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën **20,662,392 mijë lekë** dhe përbëhen nga:

Tabela nr. 5. Paraqitja e gjendjes së aktiveve në datë 31.12.2024 në mijë lekë

Emërtimi	Viti 2024	Viti 2023	Pesha % për 2024	Pesha % për 2023	Ndryshimi 24-23
I. Aktivet Afatshkurtra	2,238,430	2,363,418	10.8%	12%	(124,989)
II. Aktivet Afatgjata	18,423,962	17,275,985	89.2%	88%	1,147,977
Totali	20,662,392	19,639,403	100%	100%	1,022,988

Burimi: Bashkia Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit

Aktivet afatshkurtra.

Nga auditimi u konstatua se në vitin 2024 aktivet afatshkurtra zënë 10.8% të totalit të Aktiveve në vlerë 2,238,430 mijë lekë ndërsa aktivet afatgjata zënë 89.2% të totalit në vlerë 18,423,962 mijë lekë.

Aktivet afatshkurta përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 1,040,491 mijë lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 45,196 mijë lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 1,152,743 mijë lekë

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Tabela nr. 6. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në mijë lekë

Llog kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Ndryshimi 24-23
531	Mjete Monetare në arkë			
512	Mjete monetare në bankë			
520	Disponibilitete në thesar	1,040,491	630,396	410,094
50	Letra me vlerë			
532	Vlera të tjera			
54	Akreditiva dhe paradhënie			
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë			
	Totali	1,040,491	630,396	410,094

Burimi: Bashkia Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 1,040,491 mijë lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” në shumën 880,619 mijë lekë dhe gjendja e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” në shumën 159,871 mijë lekë.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 1,040,491 mijë lekë kuadron me llogaritë 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” dhe 466 “Mjete në ruajtje”.

Sipas akt rakordimeve mbartjet e të ardhurave për vitin 2024 paraqiten si mëposhtë:

1-Transferte e pakushtëzuar dhe specifike viti 2024 e papërdorur 383,567 mijë lekë.

2-Të ardhurat viti 2024 të papërdorura 23,999 mijë lekë.

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 407,565,555 lekë fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2025.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Tabela nr. 7. Detajet e nënrubrikës “Gjendje inventari qarkullues” në mijë lekë

Llog kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca 2024-2023
31	Materiale	1,794	3,704	(1,910)
32	Inventar i imët	43,402	57,325	(13,923)
33	Prodhim në proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambëritura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarëve			
	Totali	45,196	61,029	(15,833)

Burimi: Bashkia Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Kamëz në 31.12.2024 paraqiten në vlerën 45,196 mijë lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 1,794 mijë lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 43,402 mijë lekë.

Nga verifikimi me zgjedhje sipas ditarit të bankës u verifikuan disa shpenzime, për të cilat u kërkuar dokumentacion justifikues nga magazina për hyrjet dhe daljet e këtyre mallrave.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për të gjitha shpenzimet disponohet dokumentacioni i mëposhtëm:

-Urdhër furnizim hyrje (e firmosur nga përgjegjësi i financës);

-Fletë hyrje në magazinë;

-Urdhër furnizim shpërndarje sipas kërkesave (e firmosur nga përgjegjësi i financës);

-Fletë dalje nga magazina.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën (15,833 mijë lekë), e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.

Llogaria 31 “Materiale”, paraqitet në vlerën 1,794 mijë lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 8. Detajet e llogarisë 31 “Materiale” në mijë lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Gjendje në 01.01.2024	3,704
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2024	43,937
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	45,848
Gjendja në 31.12.2024	1,794

Burimi: Bashkia Kamëz

Llogaria 32 “Objekte inventari”, ka vlerën 43,402 mijë lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 9. Detajet e llogarisë 32 “Objekte Inventari” në mijë lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Gjendje në 01.01.2024	57,325
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2024	47,130
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	61,053
Gjendja në 31.12.2024	43,402

Burimi: Bashkia Kamëz

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Titullari i Bashkisë Kamëz ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Inventarizimi i aktiveve.

Gjatë vitit 2024, mbështetur dhe në Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar nga ana e titullarit të bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr. 984 datë 21.10.2024 për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të Bashkisë Kamëz për vitin 2024.

Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit ka në përbërje:

- 1-V. S., kryetare
- 2-D. N., anëtare
- 3-A. C., anëtare
- 4-F. D., anëtare
- 5-M. G., anëtar

Komisioni për vlerësimin dhe inventarizimin ka mbajur procesverbalin datë 06.11.2024 ku shprehet se nga verifikimi i kryer gjendja fizike e inventarëve sipas fletëve të inventarizimit rezulton i barabartë me gjendjen kontabël.

Relacioni i drejtuar Titullarit të Institucionit është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit.

Me urdhër të titullarit të Institucionit nr. 983, datë 21.10.2023 është ngritur grupi për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.

Komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve ka në përbërje:

- 1-M. A., kryetare
- 2-M. P., anëtare
- 3-M. Sh., anëtar
- 4-F. U., anëtar
- 5-F. D., anëtare

Komisioni për vlerësimin dhe inventarizimin sipas relacionit të mbajtur për aktivet e vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit ka vlerësuar si mëposhtë:

Tabela nr. 10. Aktivet e vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi në mijë lekë

Llogaritë	214	218	327	Shuma
Shkollat Kamëz		3,759	318	4,077
Zyrat Kamëz	1,998	4,474	1,934	8,405
Njësia Paskuqan		59		59
Shkollat Paskuqan		2,991	611	3,602
Totali	1,998	11,282	2,863	16,143

Burimi: Bashkia Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit

Me shkresën nr. 102 prot, datë 13.12.2024 është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kamëz procesverbali i vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi i përgatitur nga grupi i punës.

Me VKB-në nr. 122, datë 19.12.2024 “Për miratimin e efekteve financiare ekonomike të nxjerrjes jashtë përdorimit të paisjeve me vlerë 13,280 mijë lekë si dhe të materialeve me vlerë 2,863 mijë lekë”, është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit.

Me shkresën nr. 1142 prot., datë 31.12.2024 është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kamëz procesverbali i nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve, përgatitur nga grupi i punës.

Sipas relacioneve, në Bashkëpunim me Ndërmarrjen e Pastrim Gjelbërimit u krye transportimi dhe asgjësimi i aktiveve nëpërmjet procesit të thyerjes, gruposjes dhe djegies në vendgrumbullimet e përcaktuara.

Tabela nr. 11. Llog. e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”- “Të tjera aktive afatshkurtra”
në mijë lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Ndryshime 24-23
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari të ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba			
431	Tatime e taksa			
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Lokal			
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti			
435	Sigurime Shoqërore			
436	Sigurime Shëndetësore			
437,438	Organizma të tjerë shoqërore			
44	Institucione të tjera publike			
466	Kreditore për mjete në ruajtje			
468	Debitorë të ndryshëm	867,476	801,471	66,005
4342	Të tjera operacione me shtetin (të drejta)	285,268	870,522	(585,254)
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit			
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)			
	Totali			
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Furnitorë (Debitorë), parapagime pagesa pjesore			
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin			
477	Diferenca konvertimi aktive			
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime			
	Totali	1,152,743	1,671,993	(519,250)

Burimi: Bashkia Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit

Llogaritë e Klasës 4, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Kamëz në 31.12.2024 paraqiten në vlerën 1,152,743 mijë lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 867,476 mijë lekë dhe nga llogaria kontabël 4342 “Të tjera operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 285,268 mijë lekë.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 867,476 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 801,471 mijë lekë. Kjo llogari gjatë vitit 2024 ka pasur rritje në vlerën 66,005 mijë lekë, e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset, taksa e tarifa vendore familjarët, legalizime, gjoba IMTV sipas akt akordimit midis Sektorit të Taksave dhe Drejtorisë së Financës. Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqiten detyrimet si mëposhtë:

Tabela nr. 12. Detajet e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”
në mijë lekë

Lloji i Detyrimit	Detyrim 31.12.2023	Shtesa viti 2024	Pakësim viti 2024	Detyrim 31.12.2024
Detyrime Biznesi	144,411	207,084	241,919	109,576

Detyrime Familjarë	188,693	194,934	126,012	257,615
Detyrime nga Drejtoria e Investimeve Legalizimet	312,234	26,944	2,537	336,640
Detyrime te tjera	4,434	3,095	2,313	5,216
Gjoha IMTV	147,375	22,868	16,139	154,103
Detyrime punonjës ish-komuna	4,325	-	-	4,325
Shuma	801,471	454,924	388,920	867,476

Burimi: Bashkia Kamëz

Në fund të vitit 2024 evidentohet një gjendje e konsiderueshme e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” prej 867,476 mijë lekë, nga e cila vlerën më të lartë e zënë:

- Detyrime nga legalizimet në vlerën 336,640 mijë lekë ose në masën 38.8% e totalit të detyrimeve;
- Detyrime nga familjarët në vlerën 257,615 mijë lekë ose në masën 29.7% e totalit të detyrimeve;
- Detyrime Biznesi në vlerën 109,576 mijë lekë ose në masën 12.6% e totalit të detyrimeve;

Në lidhje me debitorët e taksave, rezulton se ka një rritje të debitorëve nga viti 2023 në shumën 58,495 mijë lekë nga taksat dhe tarifat vendore, rritje e cila vjen nga rritja e detyrimeve të familjarëve dhe nga legalizimet.

Gjithashtu evidentohet se taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet e reja është realizuar në një vlerë të ulët prej 2,537 mijë lekë nga 313,167 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 0.8%, ndërsa realizimi në fakt në vitin 2023 ka qenë 10,398 mijë lekë ose 7,861 mijë lekë me shumë se viti 2024. Niveli i ulët i realizimit të taksës për legalizimet e reja vjen si rezultat i dhënies së çertifikatave të pronësisë nga Kadastra, pa paguar këtë taksë.

-Gjobat nga IMTV janë falur në vlerën 151,000 mijë lekë, veprim i cili do të reflektohet në PF të vitit 2025 në bazë të Ligjit nr. 127/2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024 nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake” dhe sipas VKM-së të dalë në zbatim të tij nr. 274 datë 09.05.2025 “Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të paekzekutuara”.

Sa i takon taksave nga familjarët për vitin 2025 është ngritur grupi dhe nga verifikimet që janë bërë nga Sektori i Taksave Familjare mbi saktësinë e listës së debitorëve ndër vite, janë identifikuar një sërë problematikash dhe është saktësuar numri i debitorëve dhe vlera e detyrimeve të mbartura, sipas tabelës së mëposhtme:

Problematika	Nr	Vlerë
Ligji Nr. 10 418, datë 21.04.2011	7,571	39,305
Dublikatë	586	4,063
Faturim në UKK dhe DTTV (dublime)	1,095	13,118
Sistemim të dhënash	2,336	37,630
Total	11,588	94,116

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 285,268 mijë lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare në përputhje me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Tabela nr. 13. Detajet e nënrubrikës “Të tjera operacione me shtetin”

në mijë lekë

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408 Furnitorë e llogari të lidhura me to	150,211
Detyrime ndaj personelit llog 42	63,809
Detyrime ndaj shtetit për taim taksa llog. 431	5,641
Detyrime ndaj Sigurimeve shoqërore llog.435	19,106
Detyrime ndaj Sigurime shëndetësore llog.436	2,658
Kreditorë të ndryshëm llog.467	43,843
Totali	285,268

Burimi: Bashkia Kamëz

Nga analiza e mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është paraqitur saktë dhe kuadron me llogaritë e klasës 4.

Aktivitet Afatgjatë jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivitet Afatgjatë Jo materiale”, përbëhen nga llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe paraqiten me kosto historike në vlerën 220,767 mijë lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 116,960 mijë lekë, shtesa gjatë vitit 2024 në vlerën 30,061 mijë lekë, amortizim i vitit 2024 në vlerën 147,020 mijë lekë dhe vlerë neto 73,747 mijë lekë.

Tabela nr. 14. Detajet e nënrubrikës “Studime dhe Kërkime”

në mijë lekë

Kosto Historike	Amortizim i akumuluar datë 31.12.2023	Shtesa 2024	Amortizim vjetor 2024	Vlera kontabël neto
220,767	116,960	30,061	147,020	73,747

Burimi: Bashkia Kamëz

Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” gjatë vitit 2024 janë kontabilizuar në këtë llogari 2 projekte me vlerë 2,076 mijë lekë si vijon. Për këto projekte procedurat e prokurimit janë kryer gjatë vitit 2024.

Tabela nr. 15. Lista e projekteve të kontabilizuara në vitin 2024 në llog. 202

në mijë lekë

Nr	Emri i Projektit	Viti i rregjistrimit	Vlera historike	Amortizimi	Vlera kontabël neto
1	Ndërtim programi (databaze) program për Taksat Vendore	2024	1,140	171	969
2	Hartim Projekt Ide për objekt; Ndërtim i parkimit me 1 kat nëntokësor, objekt 3 kat të Bashkisë Kamëz dhe rehabilitimin e sheshit	2024	936	140	796
Totali			2,076	311	1,765

Burimi: Bashkia Kamëz

Amortizimi i llogarisë 202 është kryer në përputhje me UMF nr. 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Aktivitet afatgjatë materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivitet Afatgjatë Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2024, paraqiten me tepricë neto në vlerën 16,087,039 mijë lekë. Në vitin paraardhës 2023, vlera totale e AAM-ve paraqitet në vlerën 14,237,343 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 ka pasur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në vlerën 2,251,807 mijë lekë, shtesa pa pagesë në vlerën 347,699 mijë lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 23,688 mijë lekë. Pakësimet nga amortizimi gjatë vitit 2024 paraqiten në vlerën 705,698 mijë lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive në vlerën 67,780 mijë lekë.

Tabela nr. 16. Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale”

në mijë lekë

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2023	Amortizimi 2024	Shtesa/Pakësime neto 2024	Gjendja 31.12.2024
210	Toka, Troje, Terrene	348,214		258,444	606,658
211	Pyje, Kullota, Plantacione	38,949	(2,413)	(36,536)	-
212	Ndërtime e Konstruksione	4,303,829	(234,552)	1,215,763	5,285,040
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	9,245,161	(412,213)	1,003,975	9,836,924
214	Instalime dhe paisje	3,492	(1,070)	39,627	42,049
215	Mjete Transporti	31,669	(7,556)	43,133	67,245
218	Inventar Ekonomik	266,029		(16,905)	249,124
	Totali	14,237,343	(657,804)	2,507,500	16,087,039

Burimi: Bashkia Kamëz

-Llogaria 210 “Toka, troje terrene”, për vitin 2023 është paraqitur në bilanc me kosto historike në vlerën 348,214 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 llogaria 210 “Toka, troje terrene” ka pasur shtesa në vlerën 258,444 mijë lekë në bazë të regjistrimeve të pronave në zyrat e kadastrës me shkresat nr. 2715 dt 20.03.2024; nr. 4566 dt 03.06.2024 dhe nr. 5915 dt 10.07.2024. Në 31.12.2024 llogaria 210 paraqitet në vlerën 606,658 mijë lekë. Aktivët e kontabilizuar i përkasin njësisë si mëposhtë:

Tabela nr. 17. Aktivët e kontabilizuar në llogarinë 210

në mijë lekë

Nr Llog	Lloji i aktivitet	Vlera neto kontabël 31.12.2024
210	Livadh	844
210	Arrë	4,399
210	Pyje	255,881
210	Truall	262,852
210	Toka,troje,Terrene	82,682
	Total	606,658

Burimi: Bashkia Kamëz

Nga tabela e mësipërme dhe nga regjistri i aktiveve, konstatohet se zëri “pyje” në vlerën 255,881 mijë lekë dhe kullota në vlerën 201 mijë lekë janë klasifikuar në llogarinë 210 “Toka, troje terrene” dhe jo në llogarinë 211 “Pyje, Plantacione”. Ky veprim i keqklasifikimit të aktiveve rezulton jo në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

-Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”, është paraqitur në bilanc me kosto historike 40,028 mijë lekë. Gjatë vitit ka pasur nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 3,493 mijë lekë dhe pakësim në vlerën 36,536 mijë lekë, kaluar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Në 31.12.2024 llogaria 211 rezulton 0 lekë.

-Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” e cila pasqyron gjendjen e 134 aseteve për llogari të Bashkisë Kamëz, në fund të vitit 2024 rezulton me vlerë kontabël neto 5,285,040 mijë lekë. Në vitin paraardhës 2023, vlera totale e AAM-ve paraqitet 4,303,829 mijë lekë. Gjatë viti 2024 ka pasur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në vlerën 1,220,888 mijë lekë, shtesa pa pagesë në vlerën 10,202 mijë lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën (15,328 mijë) lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2024 paraqiten në vlerën 234,552 mijë lekë, ndërsa pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive nuk ka pasur.

Tabela nr. 18. Aktivët e kontabilizuar në llog 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në mijë lekë

Nr Llog	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2024
212	Ndërtesa dhe Konstruksione	6,494,302	1,209,263	5,285,040

Burimi: Bashkia Kamëz**Tabela nr. 19.** Kontabilizimet e shtuara për vitin 2024 në llogarinë 212 në mijë lekë

Nr Llog	Emërtimi	Datë	Kosto Historike	Amortizimi v 2024	Amortizimi i Akumuluar	Vlera neto kontabel
212	Rindërtim i shkollës 9 vjecare Azem Hajdari Paskuqan	25.10.2024	494,644	4,122	4,122	490,522
212	Riparim Palestre sportive shkolla Halit Coka	03.12.2024	2,232	112	112	2,120
212	Rindërtim i shkollës 9 vjecare Azem Hajdari Zall Mner	09.08.2024	267,069	4,451	4,451	262,618
212	Rindërtim i shkollës 9 vjecare Halit Coka	14.06.2024	438,373	10,969	10,969	427,403
212	Godina e MZSH në Valias	30.07.2024	17,702	369	369	17,333
	Totali		1,220,020	20,023	20,023	1,199,996

Burimi: Bashkia Kamëz

Referuar tabelës së mësipërme, gjatë vitit 2024 në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” janë kontabilizuar aktive në vlerën 1,199,996 mijë lekë.

- **Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** sipas të dhënave të pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2024, paraqiten me tepriçë neto 9,836,924 mijë lekë. Në vitin paraardhës 2023, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 9,245,161 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 ka pasur shtesë të llogarisë 213 blerje me pagesë në vlerën 1,003,975 mijë lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2024 rezultojnë në vlerën 412,213 mijë lekë.

Tabela nr. 20. Aktivët e kontabilizuar në llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në mijë lekë

Nr Llog	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2024
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	12,359,821	2,522,898	9,836,924

Burimi: Bashkia Kamëz

Lista e aktiveve të kontabilizuar në llogarinë 213 për vitin 2024 paraqitet në Aneksin 1/1 bashkëlidhur RPA.

Gjatë vitit 2024 në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë kontabilizuar aktive në vlerën 960,991 mijë lekë.

- **Llogaria kontabël 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”**, përfaqëson makineri, paisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Kamëz. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2024 paraqitet me vlerë kontabël neto 2,422 mijë lekë. Në vitin paraardhës 2023, vlera kontabël paraqitet 3,492 mijë lekë. Gjatë viti 2024 nuk ka pasur shtesë blerje me pagesë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2024 rezultojnë në vlerën 1,070 mijë lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi në vlerën 1,998 mijë lekë.

- **Llogaria 215 “Mjete transporti”**, paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Kamëz më datë 31.12.2023 me vlerë neto kontabël 31,669 mijë lekë. Sipas të dhënave të pasqyrave

individuale për të gjitha njësitë shpenzuese nga grupi i auditimit u konstatua se vlera kontabël neto e llogarisë 215 më 31.12.2024 rezulton 63,740 mijë lekë dhe përbëhet nga 16 mjete.

Tabela nr. 21. Detajet e nënrubrikës “Mjete Transporti”

në mijë lekë

Kosto Historike 31.12.2023	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Vlera neto 31.12.2023
58,002	26,333	39,627	0	7,556	63,740

Burimi: Bashkia Kamëz

Gjatë vitit 2024 ka pasur 7 mjete transporti shtesa në llogarinë 215 në vlerën 39,627 mijë lekë.

Tabela nr. 22. Lista e mjeteve të kontabilizuara në llog 215

në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Viti i regjistrimit	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera Neto
1	Furgon Volsvagen	02.05.2012	643	572	71
2	Makine Hynday	23.05.2018	5,664	4,543	1,121
3	Automjet zjarr fikses Man+pajisje	18.02.2020	13,140	8,655	4,485
4	Automjet zjarr fikses Man+pajisje	13.07.2021	14,952	7,935	7,017
5	Transit EF0YXXTTGYJR50849 AB178FN (mjet transporti)	27.06.2022	2,460	1,043	1,417
6	Automjet Zjarrfikje	05.07.2022	12,874	5,458	7,415
7	Venue kmhrc812 bnu165508 (makina e administrates)	30.05.2023	2,694	790	1,904
8	Venue kmhrc812 bnu165497(makina e administratës)	30.05.2023	2,694	790	1,904
9	Kamion shkalle zjarrfikese nafte	07.06.2024	8,880	888	7,992
10	Autoveture e re Opel Corsa VXKUPHNK5R4158102	31.10.2024	2,353	78	2,274
11	Autoveture e re Opel Corsa VXKUPHNK6R4201765	31.10.2024	2,353	78	2,274
12	Autoveture e re Opel Corsa VXKUPHNK1R4067389	31.10.2024	2,353	78	2,274
13	Fadrome kove (para kove mrapa) targa APMT 72 (sitemim veprimi kalim nga llog 327 ne llog 215)	26.12.2024	12,000	-	12,000
14	Vinç (kulle ngritese) targa AB701SA	26.12.2024	5,760	-	5,760
15	Kamion autobot	25.11.2024	5,928	99	5,829
16	Automjet (Fuoristrade)	31.08.2024	2,881	2,881	
	Totali		97,629	33,889	63,740

Burimi: Bashkia Kamëz

-Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”, përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Kamëz. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2024 paraqitet në vlerën kontabël neto 292,257 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 105,386 mijë lekë. Shtesa në llogarinë 218 është përfituar nga blerje me pagesë në shumën 11,005 mijë lekë, blerje pa pagesë në vlerën 79,053 mijë lekë dhe lëvizje të aktiveve në vlerën 15,328 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 llogaria 218 “Inventar Ekonomik” është pakësuar për vlerën bruto 25,774 mijë lekë. Pakësimi i llogarisë 218 vjen nga procedura e nxjerrjes nga përdorimi në vlerën 8,869 mijë lekë dhe pakësime të tjera në vlerën 16,905 lekë.

Tabela nr. 23. Detajet e nënrubrikës “*Inventar Ekonomik*”.

në mijë lekë

Kosto Historike 31.12.2023	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Amortizim 2024	Vlera neto 31.12.2024
381,807	115,778	105,386	25,774	53,384	292,257

Burimi: Bashkia Kamëz

Amortizimi i akumuluar më datë 31.12.2024: Kjo llogari në fund të vitit 2024, paraqitet në vlerën (4,090,734 mijë) lekë. Krahasuar me vitin 2023 amortizimi paraqitet me shtesë, e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2024.

Pasqyra statistikore nr. 7.b “Aktivet afatgjata me vlerë neto” që ka të bëjë me amortizimin vjetor 2024.

Tabela nr. 24. Detajet e nënrubrikës “*Aktivet afatgjata me vlerë neto*”.

në mijë lekë

Llogaria	Teprica në fillim			Shtesat gjatë vitit		Pakësimet gjatë vitit		Teprica në fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	A.akumuluar	Teprica neto
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	218,691	116,960	101,731	2,076	30,061			220,767	147,020	73,747
202	218,691	116,960	101,731	2,076	30,061			220,767	147,020	73,747
21-28	19,403,696	3,238,014	16,165,681	2,623,194	720,057	67,800	14,359	21,959,090	3,943,713	18,015,377
210	348,214	0	348,214	258,444	0	0	0	606,658	0	606,658
211	40,028	1,079	38,949	0	2,413	40,028	3,493	0	0	0
212	5,278,539	974,711	4,303,829	1,215,763	234,552	0	0	6,494,302	1,209,263	5,285,040
213	11,355,846	2,110,685	9,245,161	1,003,975	412,213	0	0	12,359,821	2,522,898	9,836,924
214	12,921	9,428	3,492	0	1,070	1,998	1,998	10,293	8,501	2,422
215	58,002	26,333	31,669	39,627	7,556	0	0	97,629	33,889	63,740
218	381,807	115,778	266,29	105,386	62,253	25,774	8,869	461,419	169,162	292,257
Totalli	19,622,386	3,354,974	16,267,412	2,625,270	750,118	67,800	14,359	22,179,857	4,090,734	18,089,123

Burimi: Bashkia Kamëz**Testi substancial i amortizimit.**

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në UMF nr. 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Kamëz, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5%
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi bazë grupimi) 20%
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15%

Aktivet Afatgjata Financiare.

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2024 në vlerën 1,928,338 mijë lekë. Kjo vlerë e regjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar i përket kuotave të Bashkisë Kamëz në shoqërinë “U. K.” SH.A Kamëz me NUIS L...A ku Bashkia Kamëz ka 100% të kuotave.

-Bashkia Kamëz në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të “Ujësjiellës Kanalizime Kamëz” SH.A e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i

furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij...”. Numri i aksioneve është 1,928,337 me vlerë nominale 1 mijë lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 1,928,338 mijë lekë.

Investimet.

Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të Bashkisë për vitin ushtrimor 2024, gjendja e llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” paraqitet me teprice neto 334,839 mijë lekë. Në vitin paraardhës 2023, vlera e llogarisë 231 paraqitet në shumën 1,008,573 mijë lekë. Evidentohet pakësim i kësaj llogarie në vlerën 673,734 mijë lekë.

Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” rezulton 0 lekë.

Në tabelën e mëposhtme gjendet lista analitike e projekteve në proces:

Tabela nr. 25. Detajet e nënrubrikës “Investimet”.

në mijë lekë

Nr.	Viti	PËRSHKRIMI	Përfutuese	Llog 231	Llog 231
				Rikonstrukcion rruge	Ndërtime
1	2024	Rikonstrukcion rruga Dyseldort + Bujar + Prishtina + Rrugica pingul me Europa + Dea +Rruga te Colis + Hiresia lik sit nr.1	A-2 C	8,850	
2	2024	Ndërtim Rruga Haziz Ndreu + Filip Shiroka + Rr.Asdreni +Vehbi Dibra + Irfan Strazimiri+ Demir Gashi + Nikoll Kacorri + Iljaz Pashe Dibra + Dede Plani sit 1	B. SHPK	27,094	
3	2024	Ndërtim Rruga Haziz Ndreu + Filip Shiroka + Rr.Asdreni +Vehbi Dibra + Irfan Strazimiri+ Demir Gashi + Nikoll Kacorri + Iljaz Pashe Dibra + Dede Plani sit 2	B. SHPK	13,588	
4	2024	Rikonstrukcion rruga Dyseldort + Bujar + Prishtina + Rrugica pingul me Europa + Dea +Rruga te Colis + Hiresia lik sit nr.2	A.-2. C.	11,440	
5	2024	Ndërtim Rruga Josif Mihali Rrugicat Pingul me Lidhjen e Prizrenit + Josuf Gervalla + Llazo Palluqi e Llambro Anfoni + Memo Meto	2. SHPK	7,807	
6	2024	Ndërtim Rruga Shkodra + Rruga Pingul me rrugen Jon + Rruga e re sit 1	9. SHPK	16,635	
7	2024	Ndërtim rruga Agim Nivica + seg Adem Jashari 2 rrugicat pingul me rrugen Abdyl Elmazi + Gani Duraku + rr. Hysen Cino (ndricim)+ Ali Ibra	K. SHPK	15,802	
8	2024	Ndërtim Godina 3+0 kopshti Babrru sit 1	F. 2.SHPK	-	15,582
9	2024	Rikonstrukcion rruga Dyseldort + Bujar + Prishtina + Rrugica pingul me Europa + Dea +Rruga te Colis + Hiresia lik sit nr.3	A.-2. C.	5,262	0
10	2024	Ndërtim Rruga Josif Mihali Rrugicat Pingul me Lidhjen e Prizrenit + Josuf Gervalla + Llazo Palluqi e Llambro Anfoni + Memo Meto sit 2	2. SHPK	27,994	0
11	2024	Ndërtim Rikualifikim Rruga Kujtesa+rrugicat sit nr.2	A.SHPK	44,880	0
12	2024	Ndërtim rruga Mbrt. Geraldine Rr.Teuta Rruga Mbreti Gent + Mati Prendushi + Abaz Hoxha +Seg Mark Tirtja Rruga Koco trotuaet e Mark Tirtja Paskuqan 1 Koder + Rr Mehmet Gjevori + seg Pingul me rrugën Paskuqan sit 1	C. R. 2. SHPK	16,356	0
13	2024	Ndërtim Rruga Betim Muço" lik sit 1	Sh.SHPK	22,004	0
14	2024	Ndërtim rruga Vojo Kushi + V. Prendushi + Rr pingul me konferencen e Mukjes + Rr Shtjefen Gjecovi + Mihal Grameno+ Seg. Sulejman Vokshi	K.SHPK	9,267	0
15	2024	Ndërtim Godina 3+0 kopshti Babrru sit 2	F. 2.SHPK	-	8,354
16	2024	Nd. Rrugët Xhemali Dervishi + Rruga pingul me rrugen Xhemali Dervshi Fushe Kercik Pashko Vaso	S. U. SHPK	3,391	
17	2024	Ndërtim Rruga Shkodra + Rruga Pingul me rrugen Jon + Rruga e re sit 2	9.SHPK	19,420	
18	2024	Ndërtim rruga Teuta + Rr Kacaniku e Rr Kelmendi Seg Kacaniku + RR. Legjendare +Rr. Delvine +RR. Jezerce	S.C.	7,579	
19	2024	Ndërtim Rr. Lucie Miloti + Leke Dukagjini Peqin + 3 Rrugcat paralele me peqin + marie logoreci rr pingul me azem hajdari + synej seg 1 + seg 2	B. SHPK	7,822	
20	2024	Nd. Rruget Xhemali Dervishi + Rruga pingul me rrugen Xhemali Dervshi Fushe Kercik Pashko Vaso	S. U. SHPK	5,133	
		Shuma 12 mujori 2024		270,324	23,936
1	2023	Ndërtim Rikualifikim Rruga Kujtesa+rrugicat	A. SHPK	30,136	0
2	2023	Ndërtim rruga Montreal Kamez 5	B.	10,442	
		Shuma v kaluar		40,578	0
		shuma llog 231 (progresive viti 2024)		310,903	23,936

Burimi: Bashkia Kamëz

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Kamëz më datë 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2024, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Tabela nr. 26. Detajet e nënrubrikës “Llogari të pagueshme”.

në mijë lekë

Llogaritë		Viti 2024	Viti 2023	Diferenca
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	150,211	754,244	(604,033)
42	Detyrime ndaj personelit	63,809	44,943	18,866
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	5,641	3,296	2,345
435	Sigurime shoqërore	19,106	13,494	5,612
436	Sigurime shëndetësore	2,658	1,872	786
466	Kreditorë për mjete nën ruajtje	159,871	222,831	(62,959)
467	Kreditor të ndryshëm	43,843	52,673	(8,830)
Totali		445,139	1,093,353	(648,214)

Burimi: Bashkia Kamëz

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31.12.2024 në vlerën 150,211 mijë lekë me një pakësim në vlerën 604,033 mijë lekë krahasuar me vitin paraardhës, kjo llogari përbëhet si mëposhtë:

-Fatura të muajve nëntor dhe dhjetor të cilat nuk ju ka kaluar afati 60 ditor janë në vlerën 145,645 mijë lekë dhe përbëhen nga 28 fatura tatimore.

-Fatura të palikuiduara për të cilat ka kaluar afati 60 ditor janë në vlerën 4,566 mijë lekë dhe përbëhen nga 6 fatura tatimore, jo në përputhje me disiplinën buxhetore të përcaktuar në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 52, UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184 si dhe Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7.

Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 27. Detajet e llog. 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

në mijë lekë

Emërtimi	Gjendje datë 31.12.2023	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendja 31.12.2024
Ujë 19 litër PLC	99		99	-
Ujë 19 litër PLC	80		80	-
Printim baner (500x300)	-			-
Ftesa +banera+flamuj+korniza	151		151	-
Shkuma Zjarrfikëse	115		115	-
Laser asambley Canon IR ADV 400	118		118	-
Kartona licene transport udhëtarësh taksie brenda vendit	2		2	-
Filtra ajri transit 2.0	40		40	-
Enë kuzhine	708		708	-
Gaz i lëngët	58		58	-
Ujë 19 litër PLC	423		423	-
Gomina balestre	95		95	-
Gaz i lëngët	35		35	-
Ujë 19 litër PLC	319		319	-
Grup furnizimi automatik me manometër ½	3			3
Lëshues 100-250V AC/DC	4			4
Brava dere	7		7	-
Gaz i lëngët	58		58	-
Pelet për ngrohjen e shkollave, kopshteve	6,120		6,120	-
Roba Zjarrfikëse		1,871		1,871
Mish vici		271		271
Shuma llogaria 401	8,434	2,142	8,427	2,149

Burimi: Bashkia Kamëz

Sa më sipër gjendja e llogarisë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 8,434 mijë lekë. Përgjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 2,142 mijë lekë dhe pakësime në vlerën 8,427 mijë lekë. Në fund të vitit 2024 gjendja paraqitet në vlerën 2,149 mijë lekë e përbërë nga shtesa e vitit 2024 dhe blerje në vlerën 7 mijë lekë të viteve të kaluara.

Analiza e llogarisë 404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në Aneksin 1/2 bashkëlidhur RPA.

Referuar tabelës 26, gjendja e llogarisë 404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” më 31.12.2024 paraqitet në vlerën 148,062 mijë lekë. Vlerat më të larta përfaqësohen nga projekti “Ndërtim i pedonales dhe zonave rekreative të parkut të liqenit të Paskuqanit” dhe ndërtim Rruga “Demokracia Loti III Bathore”.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 63,809 mijë lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 5,641 mijë lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor, vlera e cila është paguar në janar 2025.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”, paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhet në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 19,106 mijë lekë dhe 2,658 mijë lekë.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 159,871 mijë lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 142,006 mijë lekë (5%) si dhe garanci për ushqimin në kopshte e çerdhe si dhe garanci të tjera në vlerën 17,865 mijë lekë. Vlera e mesipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2024, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, ku për 2 garanci ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe janë akoma gjendje në llogarinë 466. Në mënyrë analitike, garancitë e të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 28. Garancitë gjendje në llog 466 që u ka kaluar afati. në mijë lekë

Nr.	Objekti	Data e akt kolaudimit	Vlera
1	Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara lik.situac 1	03.08.2022	409
2	Ndërtim kopshti Ahmet Zogu	15.04.2022	2,856
Total			3,265

Burimi: Bashkia Kamëz

Për objektin “Përmirësim i banesave ekzistuese”, sipas shpjegimeve të subjektit, garancia nuk është kaluar ende për arsye teknike, pasi operatori ekonomik ka ndryshuar emrin.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është mbivlerësuar në vlerën 3,265 mijë lekë, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”.

Kjo vlerë është çliruar gjatë vitit 2025 sipas urdhër shpenzimit nr. 1472 datë 25.09.2025 në vlerën 2,856 mijë lekë dhe urdhër shpenzimit nr. 1561 datë 07.10.2025 në vlerën 409 mijë lekë.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 43,843 mijë lekë. Kjo llogari përbëhet nga detyrimi për shpërblim lindje në vlerën 8,946 mijë lekë, vlerë e mbartur nga vitet e kaluara. Si dhe nga shpenzime pagesa të pastrimit të qytetit në vlerën 34,897 mijë lekë, vlerë për të cilën është rënë dakord me subjektin të shlyhet pasi të mbarojë procesi gjyqësor.

Tabela nr. 29. Detajet e nënrubrikës “Kreditorë të ndryshëm”.

në mijë lekë

Emërtimi	Subjekti	Gjendje më 01.01.2024	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendja më 31.12.2024
Detyrime për shpërblim lindje	Individ	8,961		15	8,946
Shpenzime pagesa e pastrimit të qytetit	E. C. SHPK	43,712	44,984	53,799	34,897
Totali		52,673	44,984	53,814	43,843

Burimi: Bashkia Kamëz

Fondi neto.

Nga auditimi konstatohet se Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive - Pasive = Aktivet Neto në vlerën 19,349,777 mijë lekë.

Nga të cilat llog 101 “Fondi i akumuluar” rezulton në vlerën 17,367,040 mijë lekë, llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 864,786 mijë lekë përfaqëson rezultatin e vitit ushtrimor 2024. Llogaria 115 “Nga fondet e veta të investimeve” rezulton në vlerën 1,117,950 mijë lekë. Llogaria 101 “Teprica/Deficiti i akumuluar”, është shtuar këtë vit me vlerën 1,128,134 mijë lekë.

Pasqyra e performancës - PASH.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare” të vitit 2024 paraqitet në Aneksin 1/3 bashkëlidhur RPA.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2024, të cilat në total janë në vlerën 3,429,686 mijë lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Tiranë paraqitet më poshtë:

-Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”**, paraqitet në PASH për vitin 2024 në vlerën **2,194,810 mijë lekë**, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7000 “Tatim mbi të ardhurat personale”**, paraqitet në vlerën 45,090 mijë lekë dhe rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”**, pasqyrohet në vlerën 1,492 mijë lekë e cila përfshin taksën mbi Biznesin e vogël dhe rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”**, pasqyrohet në vlerën 105,329 mijë lekë e cila përfshin taksën mbi ndërtesën dhe truallin dhe rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

d. Gjendja e llogarisë **7021 “Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme”** pasqyrohet në vlerën 247 mijë lekë dhe rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

e. Gjendja e llogarisë **7033 “Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie”** pasqyrohet në vlerën 84,859 mijë lekë dhe rakordon në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

f. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në vlerën 1,957,731 mijë lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin, taksën e ndikimit në infrastrukturës etj.

- Gjendja e llogarisë 71 “Të ardhurat jo tatimore” paraqitet në vlerën **319,650 mijë lekë**, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë 7109 “Të ardhura të tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në vlerën 2,811 mijë lekë, e cila përfshin, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet dhe kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë 711 “Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare”, paraqitet në vlerën 312,244 mijë lekë, e cila përfshin tarifat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca, të ardhura sekondare etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

c. Gjendja e llogarisë 719 “Të tjera të ardhura jotatimore”, paraqitet në vlerën 4,595 mijë lekë. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Tabela nr. 30. Mbi të ardhurat e trashëguara.

në mijë lekë

Emërtimi	Të ardhurat e trashëguara të vitit paraardhës 2023	Të ardhurat e vitit 2024	Të ardhurat nga Fondi i Rindërtimit	Sistemim nga thesari me të ardhurat e trashëguara nga v 2023	Shpenzimet e vitit 2024	Shpenzimet e vitit 2024 nd e varësisë	Të ardhura që mbeten për tu trashëguar në vitin pasardhës 2025
Bashkia Kamëz	407,566	3,761,381	423,268	(11,985)	3,296,508	403,102	880,619
Nga këto:							
Transf.Pakushtëzuar	20,924	846,749			632,417	84,899	150,357
Transf.Sektoriale	14,691	396,907			399,138		12,460
Të Ardhura Vendore	23,999	2,517,725		(11,985)	1,755,299	318,204	456,236
Fonde për Rindërtimin	347,952		423,268		509,654		261,567

Burimi: Bashkia Kamëz

Sipas tabelës së mësipërme, të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës rezultojnë në vlerën 407,566 mijë lekë, të ardhurat e vitit 2024 në vlerën 3,761,381 mijë lekë, si dhe të ardhurat nga fondi i rindërtimit në vlerën 423,268 mijë lekë.

Sa i takon shpenzimeve për vitin 2024 për aparatin rezultojnë në vlerën 3,296,508 mijë lekë dhe për ndërmarrjet e varësisë në vlerë 403,102 mijë lekë.

Të ardhurat që mbeten për t’u trashëguar në vitin pasardhës rezultojnë në vlerën 880,619 mijë lekë.

Nga tabela e mësipërme evidentohet sistemim i kryer me thesarin në vlerën 11,985 mijë lekë. Sipas evidencave dhe informacionit nga subjekti kjo shumë i përket taksës së mjeteve të përdorura, që i përket vitit 2024 por gabimisht nga punonjësit e thesarit është kaluar në të ardhurat e Bashkisë Kamëz në vitin 2023 dhe 2024. Më vonë është kryer stornim i kësaj shume në FSG e muajit dhjetor, pasi është firmosur procesverbali për fondet që trashëgohen nga viti 2023. Ky sistemin është reflektuar te bilanci i vitit 2024.

Analiza e llogarive të shpenzimeve për vitin 2024, të cilat në total janë në vlerën **2,564,900 mijë lekë** paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 600 “Paga, shpërblime e të tjera personeli”, paraqitet në vlerën 834,728 mijë lekë shpenzimet e konstatuara dhe sipas akt-rakordimit me thesarin rezulton në vlerën 811,265 mijë lekë shpenzimet e realizuara. Diferenca prej 23,463 mijë lekë përbën shpenzimet e konstatuara në dhjetor të cilat paguhen në janar 2025.

- Gjendja e llogarisë **601 “Kontribute për sigurime”**, paraqitet në vlerën 130,664 mijë lekë shpenzimet e konstatuara dhe sipas akt-rakordimit me thesarin rezulton në vlerën 126,518 mijë lekë shpenzime të realizuara.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”**, paraqitet në vlerën 355,441 mijë lekë shpenzimet e konstatuara dhe sipas akt-rakordimit me thesarin rezulton në vlerën 370,542 mijë lekë shpenzime të realizuara.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korrente të brendshme”**, paraqitet në vlerën 413,413 mijë lekë shpenzime të konstatuara si dhe transferimi i shumës që iu bëhet ndërmarrjeve të varësisë, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin rezulton në vlerën 95,209 mijë lekë shpenzime të realizuara.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”**, paraqitet në vlerën 814,822 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

Për vitin 2024 totali i të ardhurave rezulton në vlerën **3,429,686 mijë lekë** dhe totali i shpenzimeve është 2,564,900 mijë lekë. Diferenca e tyre në vlerën 864,786 mijë lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Tabela nr. 31. Rakordimi i shpenzimeve sipas Pasqyrave dhe sipas thesarit në mijë lekë

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2023	Detyrime të vitit 2024	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	811,265	57,436	80,890	834,728
601	126,518	6,168	10,314	130,664
602	370,542	52,147	37,046	355,441
604	95,209			95,209
606	814,837	8,961	8,946	814,822
231	2,173,275	745,810	148,062	1,575,528
Totali	4,391,646	870,522	285,268	3,806,392

Burimi: Bashkia Kamëz

Referuar të dhënave për vitin 2024, paraqitur në tabelën e mëposhtme shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në vlerën 1,755,299 mijë lekë ose në masën 40%, nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 632,417 mijë lekë ose në masën 14,4%, transfertat e pakushtëzuar sektoriale në vlerën 399,138 mijë lekë ose në masën 9%, transfertat e kushtëzuar në vlerën 1,095,138 mijë lekë ose në masën 25% dhe nga fondet e rindërtimit në vlerën 509,654 mijë lekë ose në masën 11.6%.

Tabela nr. 32. Të ardhurat dhe shpenzimet sipas burimit. në mijë lekë

Nr	Subjekti	Transfertat e pakushtëzuar + ardhurat vendore	Transfertat për Rindërtimin	Fondet e kushtëzuara	Stoku i detyrimeve të prapambetura	Huatë	Statusi i gjendjes financiare i raportuar	Te ardhurat e paperdorura për vitin 2024	Shpenzimet e realizuara për vitin 2024	Shpenzimet nd varesise se realizuara për vitin 2024	Shpenzimet e miratuara për vitin 2024
1	Fondet e Bashkisë	3,796,995	771,220	1,129,596	71,826		1.9%	915,077	4,391,646	403,102	5,688,058
1.1	Burimet e veta	3,796,995	771,220	-				880,619	3,296,508	403,102	4,558,463
-	Transferta e pakushtëzuar	862,673						150,357	632,417	84,899	862,673
-	Transferta sektoriale	416,597						12,460	399,138		416,597
-	Të ardhurat vendore	2,517,725						113,370	1,755,299	318,204	2,507,972
	Të ardhurat vendore 3% strehimi							342,866			
1.2	Fonde për Rindërtimin		771,220					261,567	509,654		771,220
2	Fondet e Kushtëzuara			1,129,596				34,457	1,095,138		1,129,596

Burimi: Bashkia Kamëz

Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Kamëz).

-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”.

Referuar kërkesave të VKM-së nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Kamëz është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Sipas listë pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2024 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës znj. V. S. dhe nga specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari i Bashkisë. Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Drejtori i Burimeve Njerëzore znj. R. H.

Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2024.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar dhe Dhjetor 2024) dhe konstatohet se ato plotësohen sipas rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Kamëz, janë në përputhshmëri me kërkesat e Ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

Tabela nr. 33. Burimi i financimit të pagave.

në mijë lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transferte specifike
Viti 2024	1,007,560	937,783	93.1 %	259,489	322,377	10,963	344,953

Burimi: Bashkia Kamëz

Tabela nr. 34. Realizimi i fondit të pagave, sigu shoqërore dhe fondit të veçantë.

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	VITI 2024		
		Plani	Fakti	%
1	Fondi i Pagave	866,900	811,265	94
2	Fondi i Siurimeve Shoqërore	140,659	126,518	91

Burimi: Bashkia Kamëz

Të ardhurat dhe shpenzimet sipas buxhetit.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2024- 2026 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, VKB nr. 103 datë 18.12.2023 “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Kamëz për vitet 2024-2026”, konfirmuar nga Instituti i Prefektit Qarkut Tiranë me shkresën nr. 1666/2 datë 26.12.2023.

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2024 kanë vlerën 2,802,116 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 767,231 mijë lekë, transferta specifike (sektoriale) ka vlerën 377,039 mijë lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 3,946,385 mijë lekë dhe shpenzimet kanë vlerën 3,946,385 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024, Bashkia Kamëz me VKB nr. 22, datë 22.02.2024 ka ndryshuar vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten si vijon:

Janë alokuar fondet e trashëguara nga viti 2023, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 407,566 mijë lekë;

Janë alokuar fonde shtesë transferte specifike për arsimin parashkollor nga ministria e linjës, për efekt të mbulimit të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore si efekt i rritjes së pagës minimale në vlerën 18,458 mijë lekë; Janë alokuar fonde për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 54,997 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten në Ankesin 1/4.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, të dhënat për vitin 2024 paraqiten në Ankesin 1/5.

Sipas kësaj tabele, plani rezulton në vlerën 2,889,983 mijë lekë dhe realizimi rezulton në vlerën 2,517,725 mijë lekë ose në masën 87%, me një mosrealizimin në vlerën 372,258 mijë lekë.

Referuar të dhënave, me nivel më të ulët realizimi rezultojnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat si vijon:

- Taksë për hapësira publike me vlerë të planifikuar 964 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 95 mijë lekë ose në masën 9.8%;

- Taksë hoteli me vlerë të planifikuar 283 mijë lekë dhe realizimi në vlerë 179 mijë lekë ose në masën 63.3%;

- Taksa e pasurisë, ndërtesë me vlerë të planifikuar 146,082 mijë lekë dhe realizimi në vlerë 99,584 mijë lekë ose në masën 68.2%;

- Taksa mbi tokën bujqësore me vlerë të planifikuar 8,446 mijë lekë dhe realizimi në vlerë 5,745 mijë lekë ose në masën 68%;

- Tarifë legalizimi me vlerë të planifikuar 313,167 mijë lekë dhe realizimi në vlerë 2,537 mijë lekë ose në masë 0.8%;

- Tarifë leje transporti me vlerë të planifikuar 23,461 mijë lekë dhe realizimi në vlerë 14,680 mijë lekë ose në masën 62.6%;

- Të ardhura të tjera me vlerë të planifikuar 222,266 mijë lekë dhe realizimi në vlerë 116,029 mijë lekë ose në masën 52.2%;

Ndërsa me mbi realizim rezultojnë:

- 3% nga kontributi i subjekteve private sipas ligjit për strehimin me vlerë të planifikuar 49,440 mijë lekë dhe realizimi në vlerë 342,866 mijë lekë ose në masën 693.5%; Në këtë rast vlera e realizuar rezulton shumë herë më e lartë se plani, pas daljes së VKM-së nr. 325 datë 29.05.2024 “Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale”, në zbatim të Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar, ku vlera për strehim social mund të jepet ekuivalente në vlerë monetare;

- Shitje pasurie dhe privatizim banese është planifikuar në vlerën 340 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 764 mijë lekë ose në masën 225%;

- Taksë parkimi është planifikuar në vlerën 3,700 mijë lekë dhe realizim në vlerën 5,031 mijë lekë ose në masën 136%;

- Taksë tabelë është planifikuar në vlerën 565 mijë lekë dhe realizim në vlerën 886 mijë lekë ose në masën 156.8%;

Sa më sipër, evidentohen diferenca sipas zërave të të ardhurave sa i takon planifikimit dhe realizimit të tyre me një mosrealizimin në vlerën 373,422 mijë lekë.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve

Referuar planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve, të dhënat për vitin 2024 paraqiten në Ankesin 1/6.

Sipas kësaj tablele plani përfundimtar i shpenzimeve rezulton në vlerën 5,600,740 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 4,391,646 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 1,209,094 mijë lekë ose në masën 78%.

Në mënyrë analitike situata paraqitet si vijon:

-Zëri 600 “Paga dhe shpenzime personeli” është planifikuar në vlerën 866,900 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 811,265 mijë lekë ose në masën 93.6%, me mosrealizim në masën 6.4%;

-Zëri 601 “Sigurime Shoqërore & Shëndetësore” është planifikuar në vlerën 140,659 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 126,518 mijë lekë ose në masën 90%, me mosrealizim në masën 10%;

-Zëri 602 “Shpenzime operative” është planifikuar në vlerën 483,498 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 370,542 mijë lekë ose në masën 77%, me mosrealizim të lartë në masën 23%;

-Zëri 604 “Transferime korrente të brendshme tek individë” është planifikuar në vlerën 104,817 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 95,209 mijë lekë ose në masën 91%, me mosrealizim në masën 9%;

-Zëri 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë- Ndihmë ekonomike” është planifikuar në vlerën 1,143,207 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 814,837 mijë lekë ose në masën 71%, me mosrealizim të lartë në masën 29%;

-Zëri 230-231 “Investime” është planifikuar në vlerën 2,861,658 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 2,173,275 mijë lekë ose në masën 76%, me mosrealizim të lartë në masën 24%;

Përsa trajtuar më sipër, zërat 602, 606 dhe 231 paraqiten me nivelin më të lartë të mosrealizimit.

-Nga analiza e të dhënave të buxhetit rezulton se ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, në vlerën 1,209,094 mijë lekë për shpenzimet, duke sjellë që buxheti për vitin 2024 të ketë mosrealizime në masën 22%.

Detyrimet e prapambetura.

Situata e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2024 paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Tabela nr. 35. Situata e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2024 në mijë lekë

Kodi i DP	Emërtimi	DP progresiv deri në dt. 31.12.2023	Shtesa DP gjatë vitit 2024	Pagesa gjatë vitit 2024	DP datë 31.12.2024
4864100	Detyrime për vend. Gjyqësore				
4864200	D.P.për shërbime				
4864300	D.P.për mirëmbajtje				
4864400	D.P.për investime	88,073	25,046	75,293	37,826
4864400	D.P. për investime nga Ministrinë e Linjës				
4865600	D.P për mallra	6,120		6,120	
4864900	D.P.të tjera	43,712		9,712	34,000
	Totali	137,905	25,046	91,125	71,826

Burimi: Bashkia Kamëz

Nga auditimi konstatohet se, detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2023 kanë qenë në vlerën totale prej 137,905 mijë lekë, gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime në vlerën 25,046 mijë lekë dhe janë shlyer detyrime në vlerën 91,125 mijë lekë, duke rezultuar në fund të vitit 2024 një vlerë e detyrimeve të prapambetura prej 71,826 mijë lekë. Kjo vlerë përbëhet nga detyrime për investime në vlerën 37,826 mijë lekë dhe detyrime të tjera në vlerën 34,000 mijë lekë, që përfshin pagesa periodike sipas nenit 16 të kontratës së koncensionarit për pastrimin e qytetit (E. C.). Me këtë

shoqëri është lidhur një marrëveshje për shmangie kamatëvonesash dhe çështja është në proces gjyqësor. Me shkresën nr. 20 prot., datë 25.03.2024 shoqëria E. C. ka shprehur pëlqimin për mbajtjen e vlerës së investimit të parealizuar deri në zgjidhjen e çështjes nga një gjykatë kompetente dhe deklaroi se për këtë vlerë nuk do të kërkohet kamatëvonesë.

Gjatë vitit 2025 nga detyrimi në vlerën 37,826 mijë lekë janë likuiduar detyrimet në 5 raste në vlerën 31,091 mijë lekë dhe ka ngelur pa shlyer vlera 6,735 mijë lekë.

Situata e vështirësisë financiare

në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Hua			
b.2	Overdraft			
b.3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	71,826		
				1.9%
a	Shpenzime korrente			
a.1	Mallra dhe shërbime			
a.2	Paga dhe sigurime			
a.3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale			
b.1	Insitucione buxhetore			
b.2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore	71,826		
c.1	Marrëdhënie pune			
c.2	Mallra dhe shërbime			
c.3	Investime	37,826		
c.4	Të tjera	34,000		
III	Totali (I+II)		3,777,966	1.9%

Burimi: Bashkia Kamëz

Me shkresën nr. 1999 prot., datë 27.02.2025 është dërguar në Ministrinë e Financave vetëvlerësimi financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2024. Referuar të dhënave të raportimit të detyrimeve të prapambetura në MF, evidentohet se ka rakordim të vlerës së detyrimeve të prapambetura.

Raportet e monitorimit.

Për vitin 2024 janë përgatitur raporte 4-mujore për monitorimin e procesit të buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit. **Për vitin 2024** janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:

“Raport monitorimi 4 mujori i parë i vitit 2024” me shkresën nr. 4482 prot., datë 30.05.2024

“Raport monitorimi 8 mujori i vitit 2024” me shkresën nr. 7573 prot., datë 13.09.2024

“Raport monitorimi janar-dhjetor 2024” me shkresën nr. 1936 prot., datë 27.02.2025.

Nga auditimi i raporteve të monitorimit rezulton se në to janë pasqyruar saktë treguesit e realizimit të buxhetit referuar dhe akt akordimit me degën e thesarit.

Formati nr. 4 “Pasqyra e flukseve monetare” (Cash Flow)

Pasqyra e fluksit të parave (Cash Flow) tregon **hyrjet dhe daljet e parave të gatshme** gjatë vitit 2024. Kjo pasqyrë është thelbësore për të kuptuar **aftësinë e bashkive për të gjeneruar, përdorur**

dhe menaxhuar likuiditetin, që siguron ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve publike. Sipas pasqyrës së Bashkisë Kamëz evidentohet se nga veprimtaria e shfrytëzimit ka pasur arkëtime në vlerën 3,008,696 mijë lekë dhe pagesa në vlerën 2,326,973 mijë lekë. Nga veprimtaria e investimit vlera rezulton 166,105 mijë lekë dhe nga transferta të tjera vlera (437,734 mijë lekë).

Formati nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit”

-Zëri “Burimet për investime” Formati 6, i plotësuar për shumën 2,263,176 mijë lekë në analizë tregon tregon investimet që ka realizuar bashkia dhe me çfarë burimesh janë financuar ato, duke përfshirë burimet e veta, transferat nga qeveria qendrore dhe donatorë të jashtëm.

Formati nr. 8 “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”

Ky format tregon **strukturën e punësimit dhe shpenzimet për pagat** në bashki gjatë periudhës ushtrimore 2024. Sipas tabelës numri i punonjësve të rinj të pranuar rezulton 275, numri i punonjësve të larguar 107 dhe numri i punonjësve në fund të vitit 2024 rezulton 1013.

Nga testi i kontrollit për vitin 2024 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limitin e arkës. Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të vendimit nr. 290, datë 14.06.1993 "Për limitin e arkës".

Ligjshmëria dhe saktësia e e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listëpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive.

Në lidhje me këtë drejtim të auditimit, për Projektraportin e auditimit të dërguar me shkresën nr. 738/3 prot., datë 11.09.2025, janë paraqitur pretendime/observacione nga subjekti i audituar Bashkia Kamëz me nr. 8726 prot., datë 09.10.2025 protokolluar në KLSH me nr. 738/4 datë 09.10.2025.

Pretendimi i subjektit: Për llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, ku ka kaluar afati për 2 garanci dhe janë gjendje në vlerën 3,265 mijë lekë, iu bëjmë me dije se:

Janë likuiduar detyrimet: Sipas urdhër shpenzimit nr. 1472 datë 25.09.2025 në vlerën 2,856 mijë lekë, për objektin “Ndërtim kopshti Ahmet Zogu”; Sipas urdhër shpenzimit nr. 1561 datë 07.10.2025 në vlerën 409 mijë lekë, për objektin “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra”.

Në lidhje me detyrimet e prapambetura, iu bëjmë me dije se:

Janë likuiduar detyrimet, në 5 raste në vlerën 31,091 mijë lekë, (urdhër shpenzimit nr. 92 datë 03.02.2025, nr. 155 datë 04.02.2025, nr. 148 datë 04.02.2025, nr. 157 datë 04.02.2025, nr. 1195 datë 07.08.2025). Ndërsa për vlerën 34,000 mijë lekë detyrim ndaj shoqërisë E. C., kjo vlerë është mbajtur si vlerë e ngurtësuar e parashikuar në kontratë me dakortësinë e palëve. Pra vlera e detyrimeve të prapambetura ka ardhur në ulje dhe ka vlerë të papërfillshme në totalin e buxhetit të bashkisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me spjegimet më sipër, referuar llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” nga urdhërshpenzimet e vendosura në dispozicion verifikohet se këto garanci janë çliruar, si rrjedhojë observacioni merret në konsideratë dhe ndryshimet përkatëse janë reflektuar përgjatë materialit. Lidhur me observacionin mbi detyrimet e prapambetura observacioni merret parasysh për vlerën e detyrimeve që janë shlyer përgjatë vitit 2025 dhe konstatimi qëndron për pjesën e mbetur të detyrimit.

2.3. Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Në auditimin e statusit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vendosur në dispozicion informacioni si në vijim:

- *Shkresa përcjellëse e Raportit dhe zbatimit të rekomandimeve;*
- *Plan veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve, i miratuar nga titullari i Bashkisë Kamëz dhe dërguar në KLSH;*
- *Informacioni i dërguar në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve;*
- *Dokumentacion i subjektit mbi zbatimin e rekomandimeve.*

Nga verifikimi rezultoi që:

I- Programi i Auditimit nr. 1085/1 prot., datë 12.09.2024- Auditim Financiar

1-Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “*Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin Financiar të ushtruar në Bashkinë Kamëz*”, me nr. 1085/8 prot., datë 25.03.2025, sipas Programit të Auditimit nr. 1085/1 prot., datë 12.09.2024, janë rekomanduar për zbatim:

- **13 rekomandime** “Masa organizative”;
- **3 rekomandime** “Për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)”
- **4 rekomandime** “Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, me efekt mungese të ardhurash”;
- **5 rekomandime** “Masa disiplinore”;

Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve

Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 15, gërma j, Bashkia Kamëz duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit.

- **Nga auditimi u konstatua se**, Bashkia Kamëz për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 1085/8 prot., datë 25.03.2025 ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 3243 prot., datë 10.04.2025, ku pasqyrohen veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve dhe strukturat përgjegjëse. Është hartuar plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, me shkresën nr. 3066 prot. datë 04.04.2025, nga grupi i punës i ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë me nr. 261 prot. datë 28.03.2025.

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

- Referuar shkresës nr. 1085/8 prot., datë 25.03.2025, për dërgimin e raportit përfundimtar dhe rekomandimeve nuk është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 5, të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

- Nga verifikimi rezulton se Bashkia Kamëz ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1085/8 prot., datë 25.03.2025, dhe ka raportuar rregullisht në këshillin e njësisë (Këshillin Bashkiak), në përputhje me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë. Konkretisht është raportuar me shkresën nr. 3242 prot. datë 10.04.2025.

II- Programi i Auditimit nr. 1370 prot., datë 13.11.2024- Zbatimi i rekomandimeve

1- Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin Tematik (për zbatimin e rekomandimeve) të ushtruar në Bashkinë Kamëz”, me nr. 1370/48 prot., datë 08.04.2025, sipas Programit të Auditimit nr. 1370 prot., datë 13.11.2024, janë rekomanduar për zbatim:

- **1 rekomandim** “Masa organizative”;
- **3 rekomandime** “Masa shpërblim dëmi”;
- **4 rekomandime** “Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim/taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia”;
- **1 rekomandim** “Masa disiplinore”;

Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j, Bashkia Kamëz duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit.

- Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Kamëz për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 1370/48 prot., datë 08.04.2025 ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 3700 prot., datë 25.04.2025, ku pasqyrohen veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve dhe strukturat përgjegjëse. Është hartuar plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, me shkresën nr. 3499 prot. datë 17.04.2025, nga grupi i punës i ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë me nr. 291 prot. datë 15.04.2025.

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

- Referuar shkresës nr. 1370/48 prot., datë 10.04.2025, për dërgimin e raportit përfundimtar dhe rekomandimeve nuk është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH siç përcaktohet në nenin 50-Auditimi i jashtëm, pika 5, të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

- Nga verifikimi rezulton se Bashkia Kamëz ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1370/48 prot., datë 08.04.2025, dhe ka raportuar rregullisht në këshillin e njësisë (Këshillin Bashkiak), në përputhje me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë. Konkretisht është raportuar me shkresën nr. 3557 prot. datë 22.04.2025.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

I-Programit të Auditimit nr. 1085/8, datë 25.03.2025

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **13** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 11 janë zbatuar, 2 janë në proces zbatimi.

Pra janë zbatuar 85% e masave organizative dhe 15% janë në proces zbatimi.

- Për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) janë lënë 3 rekomandime dhe janë pranuar plotësisht. Nga rekomandimet e lëna rezulton se është zbatuar 1 rekomandim dhe janë në proces zbatimi 2 rekomandime.

- Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, me efekt mungese të ardhurash financiare janë lënë 4 rekomandime dhe janë pranuar plotësisht. Nga rekomandimet e lëna rezulton se janë zbatuar 2 rekomandime dhe janë në proces zbatimi 2 rekomandime.

- Është lënë 1 masë administrative, e cila është zbatuar.

- Janë lënë 5 masë disiplinore, të cilat janë zbatuar.

II- Programit nr. 1370/48, datë 08.04.2025

-Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1** masë organizative dhe është pranuar, e cila rezulton në proces zbatimi.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë 3 rekomandime për 3 subjekte në vlerën 840 mijë lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat të cilat janë zbatuar 3 rekomandime për 3 subjekte në vlerën 840 mijë lekë.

-Për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) janë lënë 4 rekomandime dhe janë pranuar plotësisht. Nga rekomandimet e lëna rezulton se është zbatuar 1 rekomandim dhe janë në proces zbatimi 3 rekomandime.

- Është lënë 1 masë disiplinore, e cila është zbatuar.

Në vijim, në mënyrë të përmblëdhur janë paraqitur rekomandimet e lëna nga KLSH, referuar auditimeve të mëparshme, sipas Programit të Auditimit nr. 1085/8, datë 25.03.2025 dhe Programit nr. 1370/48, datë 08.04.2025, sipas tabelës më poshtë:

Lloji i masës	Propozuar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
I- Programi nr. 1085/8, datë 25.03.2025						
Organizative	13	13	11	-	2	-
Shperblim dëmi	-	-	-	-	-	-
Të Ardatura	3	3	1	0	2	-
EEE	4	4	2	1	1	
Disiplinore	5	5	5	-	-	-
Administrative	1	1	1	-	-	-
Totali I	26	26	20	1	5	0
II- Programi nr. 1370/48, datë 08.04.2025						
Organizative	1	1	-	-	1	-
Shperblim dëmi	3	3	3	-	-	-
Të Ardatura	4	4	1	-	3	-
EEE	0	0	-	-	-	-
Disiplinore	1	1	1			-
Administrative	-	-	-	-	-	-
Totali I	9	9	5		4	-
Totali I+II	35	35	25	1	9	-

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshëm paraqitet si vijon:

I- Programi i Auditimit nr. 1085/1 prot., datë 12.09.2024- Auditimi Financiar

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin në Bashkinë Kamëz sipas programit të Auditimit nr.1085/1 prot., datë 12.09.2024- Auditimi Financiar, dërguar me shkresën nr. 1085/8 prot., datë 25.03.2025.

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Koordinatorin e MFK-së, të marrin masa për: Hartimin e planeve të trajnimit për njohjen e punonjësve lidhur me bazën rregullatore të Bashkisë dhe Kodin Etik, hartimin e planeve vjetore për trajnimet e brendshme për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të Bashkisë, hartimin e procedurave të shkruara mbi rregullat e raportimit gjithëpërfshirëse, si dhe hartimin e Planit të Veprimtimit për Kontrollin e Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhrin nr. 278 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e BNJ dhe Koordinatori për MFK për zbatimin e rekomandimit. Trajnimet janë kryer në bashkëpunim me Institutin e Trajnimeve të Administratës Publike. Gjatë vitit 2024 janë ndjekur 124 trajnime të organizuara kryesisht nga ASPA. Trajnimet kanë qenë trajnime të detyrueshme dhe trajnime profesionale.

Çdo fillim viti miratohet plani i trajnimeve për punonjësit. Për vitin 2024 me shkresën nr. 8637/1 prot. datë 30.11.2023, DBNJ ka hartuar planin e trajnimeve për vitin 2024. Drejtoria e Burimeve Njerëzore komunikon me institucione të ndryshme dhe ASPA, për çdo trajnim që zhvillohet dhe njofton drejtoritë respektive të bashkisë për ndjekjen e trajnimeve në vijim.

Është hartuar programi vjetor i trajnimeve të brendshme me aktin nr. 2346 prot. datë. 10.03.2025. Në këtë plan është planifikuar trajnim për njohje me rregulloren e brendshme dhe kodin e etikës për të gjitha drejtoritë. Gjithë punonjësit janë bërë me dije për rregulloren e brendshme dhe kodin etik të institucionit duke ju dërguar në rrugë elektronike (email) të gjitha drejtorive.

Është hartuar plani i veprimit të KB si pjesë e pyetësorit të vetëvlerësimit me shkresën nr. 1982 prot., datë 27.02.2025.

Rekomandimi është zbatuar.

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa që të arkivojë dosjet e auditimit të realizuara dhe të ndjekë këtë praktikë në përfundim të auditimeve në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhrin nr. 279 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Auditimit të Brendshëm për zbatimin e rekomandimit.

Nga drejtoria e Auditimit të Brendshëm është bërë arkivimi i dokumentacionit me procesverbal, konkretisht sipas procesverbalit nr. 3845 prot. datë 30.04.2025.

Rekomandimi është zbatuar.

3.1.Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrin masa për likuidimin në kohë, të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë Degës së Thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i pranimit të faturës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhrin nr. 280 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Financës & Buxhetit për zbatimin e rekomandimit. Në vijimësi faturat janë likuiduar bazuar në planifikimin buxhetor.

Rekomandimi është zbatuar.

4.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që, gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të kryejë parashikime bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm, si dhe arkëtimet nga debitorët për taksat dhe tarifave vendore nga vitet paraardhëse, me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë dhe kryerjes së shpenzimeve të planifikuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se me urdhër nr. 281 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore për zbatimin e rekomandimit. Për parashikimin DTTV është bërë bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë si dhe është marrë parasysh edhe realizimin faktik të viteve të mëparshme.

Rekomandimi është zbatuar.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që, të plotësojë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dosjet e subjekteve tatim-paguese, ndryshimet në sistem

në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore, të shoqërohen me dokumentacionin përkatës vërtetues, duke kryer monitorimin e kësaj procedure.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se me urdhër nr. 281 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore për zbatimin e rekomandimit. Sektori i Verifikimit në Terren, pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKB-së nr.120 datë 19.12.2024 "Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz", Urdhërit nr. 10177 prot., datë 12.12.2024 "Për plotësimin e dosjeve të taksapaguesve me dokumentacion përkatës", pas verifikimeve që kryhen në terren si dhe dokumentacionit që depozitohet nga subjektet tatimpaguese, mban akt-kontrollet dhe procesverbalet për përlogaritjen e detyrimeve vendore sipas parashikimeve ligjore të paketës fiskale në fuqi. Për dosjet e subjekteve tatimpagues në Bashkinë Kamëz administrohet dokumentacioni si më poshte, vijon:

- Inventari i dosjes (ku evidetohet dokumentacioni justifikues i tarifimit të subjekteve);
- Certifikata e regjistrimit të subjektit tatim-pagues;
- Ekstrakti historik i Qendrës Kombëtare të Biznesit;
- Përgjegjësia tatimore e subjektit tatimpagues;
- Dokumentacioni justifikues për tabelat që kanë funksion reklamues;
- Mjeti identifikimit;
- Dokument pronësie për objektin ku zhvillohet aktiviteti;
- Korrespondenca me subjektet tatimpaguese sipas rastit (Kërkesat për informacion etj, Vendimet e Komisionit të Apelit, etj).

Sektori i Vlerësimit dhe Regjistrimit të detyrimeve, ndryshimet në sistem në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore, i bën vetëm kur praktika e ardhur nga inspektorët e verifikimit në terren shoqërohet me dokumentacionin përkatës vërtetues duke kryer monitorimin e kësaj procedure deri në printimin e njoftim- detyrimit.

Rekomandimi është zbatuar.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Kontabilitetit të marrë masa për vlerësimin dhe kontabilizimin e aktiveve në llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene" me vlerë të drejtë.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare 2024

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se me urdhër nr. 280 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Financës & Buxhetit për zbatimin e rekomandimit. Drejtoria e Financës Bazuar në informacionin e Drejtorisë së Kadastrës ka bërë regjistrimin e aktiveve në llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene" në pasqyrat financiare të vitit 2024.

Në zbatim të VKM-së nr.89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës sipas çmimeve të vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", është ngritur një grup pune i përhershëm me Urdhër nr.466, datë 10.05.2024, i cili bën përlogaritjen e vlerës së çdo pronë që do të certifikohet në emër të Bashkisë Kamëz dhe raporton pranë Drejtorisë së Financës me qëllim pasqyrimin e kësaj vlerë në pasqyrat financiare të Bashkisë Kamëz. Pasuritë e certifikuara deri tani janë dërguar pranë Drejtorisë së Financës për kontabilizim me shkresat:

1. Shkresa nr.2715 prot., datë 20.03.2025
2. Shkresa nr. 5915/1 prot., datë 10.07.2024
3. Shkresa nr.4566 prot., datë 03.06.2024
4. Shkresa nr.1739 prot., datë 28.02.2024

Për pasuritë të llojit "shkembore", "zallishte", "ranishte", "rezervuar", nuk është bërë e mundur përcaktimi i vlerës së tyre, për shkak të mungesës së referencave ligjore për vlerën, por është bërë pasqyrimi i tyre në kontabilitet me vlerë 0.

Nga drejtoria e financës është hartuar regjistri i aktiveve për të gjitha aktivet që zotëron.

Rekomandimi është zbatuar.

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Projekteve dhe Investime, Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të aseteve të marrë masa që për asetet të cilat do të kryhen investime kapitale, të disponojnë dokumentacionin e pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhër nr. 280 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve për zbatimin e rekomandimit.*

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për këtë proces, shkresat dhe evidencat, rezulton se janë çertifikuar pasuritë pa problematika, në proces çertifikimi pasuritë e mbetura si dhe pasuritë që do të transferohen rishtazi, në kuadër të procesit të përditësimit. Në total janë certifikuar 58 pasuri.

-Nga verifikimi rezultoi se për dy shkolla (shkolla Sulejman Elezi Laknas dhe shkolla Angela Merkel Kamëz) të cilat janë paisur me leje ndërtimi gjatë vitit 2024 disponojnë dokument pronësie.

Ndërkohe vazhdon procesi i verifikimit dhe i komunikimin me institucionet kompetente në lidhje me pasuritë me problematika.

Rekomandimi është zbatuar.

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Projekteve dhe Investimeve, të marrin masa, për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 dhe duke njoftuar subjektet, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm, për të sistemuar dhe zhbllokuar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se me urdhër nr. 288 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Financës & Buxhetit për zbatimin e rekomandimit. Llogaria 466 është sistemuar.*

Me urdhër nr. 1163 prot. datë 24.12.2024 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të katër objekteve me vlerë të garancisë së punimeve 283,214 lekë. Me procesverbal nr. 1163/1 datë 24.12.2024 grupi i punës ka vendosur të mos likuidohet garancia e punimeve për këto objekte.

Me datë 31.12.2023 kjo llogari kishte vlerën 206,631,705 lekë, gjatë vitit 2024 është shtuar vlera prej 41,380,399 lekë, është pakësuar vlera 106,005,874 lekë. Me datë 31.12.2024 kjo llogari ka vlerën 142,006,230 lekë e cila e cila është garanci punimesh për objekte brenda periudhës së garancisë. Gjatë vitit 2025 kjo llogari është pakësuar me 15,336,267 lekë.

Rekomandimi është zbatuar.

9.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve të marrin masa për inventarizimin e plotë të pasurive të paluajtshme, duke e përditësuar vazhdimisht inventarin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: *Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhër nr. 280 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve për zbatimin e rekomandimit. 1. Është Miratuar Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.108, datë 05.11.2024 “Për përditësimin e pjesshëm të Listës së Inventarit të pronave shtetërore të transferuara në pronësi apo përdorim të Bashkisë Kamëz me VKM-në nr. 775, datë 05.09.2013”.*

Me shkresën nr.10977 prot., datë 24.12.2024 është kërkuar statusi juridik për 100 pasuri që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Paskuqan, të identifikuara të lira në terren nga Grupi i Punës. Për pasuritë që rezultojnë "shtet", do të kryhet procedura për transferimin në pronësi.

2.Në zbatim të Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM-së nr.28, datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave

shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve” me Urdhrin nr.351, datë 06.06.2023 “Mbi ngritjen e grupit të punës për verifikimin, saktësimin, inventarizimin, plotësimin dhe përditësimin e pronave shtetërore, të transferuara me VKM në pronësi ose përdorim të Bashkisë Kamëz, si dhe pronave që nuk janë transferuar me VKM” është ngritur Struktura e Posaçme e cila po punon për përditësimin e Listës së Inventarit.

Nga kjo strukturë janë verifikuar në terren gjatë vitit 2023-2024 në total **678 pasuri**. Për pasuritë e evidentuara, referuar dokumentacionit që disponon drejtoria dhe gjendjes faktike në terren, në mënyrë të përmbledhur janë konstatuar problematikat e mëposhtme: Për pasuritë të cilat kanë rezultuar pa problematika specifike (të zëna me ndërtim pa leje në terren, të ndara me ligjin nr.7501, zona me harta të paazhornuara etj.) është kërkuar statusi juridik pranë DVASHK-së Kamëz-Vorë, duke vazhduar me procesin e përditësimit si më poshtë"

Kërkesë për status juridik DVASHK-së Kamëz-Vorë	211 pasuri	1.Shkresa nr.2103, datë 12.03.2024 2.Shkresa nr.7421, datë 09.09.2024 3.Shkresa nr.10977, datë 24.12.2024
Sipas VKM-së nr.317, datë 10.06.1995 “Për sistemin me tokë dhe truall të fshatrave Zallmner, Bulçesh dhe Brurëz” dhe VKM-së nr.828, datë 23.11.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për kalimin e së drejtës së pronësisë, pa pagasë, mbi truallin dhe objektet e ndërtuara për familjet e shpërngulura nga ndërtimi i ujëmbledhësit të Bovillës”	395 pasuri të transferuara në përdorim të Bashkisë Kamëz, kanë kaluar sipas këtyre dy VKM-ve në pronësi të shpërngulurve të Bovillës.	1.VKM-së nr.317, datë 10.06.1995 2.VKM-së nr.828, datë 23.11.2016
Pasuri të transferuara në pronësi sipas Listës së Inventarit, por që rezultojnë të ndara sipas ligjit nr.7501 “Për tokën”.	7 pasuri	Formulari 06

Ne total janë certifikuar 58 pasuri.

Referuar të dhënave të mësipërme dhe kthim-përgjigjeve nga DVASHK-ja Kamëz-Vorë, Struktura e Posaçme ka hartuar Projekt-Vendimin nr.80, datë 21.10.2024, Për përditësimin e pjesshëm të Listës së Inventarit të pronave shtetërore të transferuara në pronësi apo përdorim të Bashkisë Kamëz me VKM-në nr.775, datë 05.09.2013”, i cili është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.108, datë 05.11.2024 dhe është konfirmuar ligjshmëria e tij me shkresën nr.1495, datë 14.11.2024 të Prefektit të Qarkut Tiranë. Ky vendim është dërguar pranë ASHK-së, Drejtorisë së Pronave Shtetërore me shkresën nr.10125, datë 02.12.2024, me qëllim miratimin e përditësimit të pjesshëm të Listës së Inventarit nga Këshilli i Ministrave. Struktura e Posaçme vazhdon punën në funksion të përditësimit të Listës së Inventarit. Theksojmë se kemi hasur vështirësi në proces për shkak të problematikave që lidhen me mosazhurnimin e hartave, ndërtimeve pa leje të palegalizuara si dhe vonesat në përcjelljen e statuseve juridike nga DVASHK Kamëz-Vorë.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe të Kontabilitetit duhet marrin masa për të krijuar, përditësuar dhe administruar një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhër nr. 282 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve për zbatimin e rekomandimit.

Në zbatim të VKM-së nr.89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës sipas çmimeve të vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, është ngritur një grup pune i përhershëm me Urdhrin nr.466, datë 10.05.2024, i cili bën përllogaritjen e vlerës së çdo prone që do të certifikohet në emër të Bashkisë Kamëz dhe raporton pranë Drejtorisë së Financës me qëllim pasqyrimin e kësaj vlere në pasqyrat financiare të Bashkisë Kamëz. Theksojmë se pasuritë e certifikuara deri tani janë dërguar për kontabilizim pranë Drejtorisë së Financës. Janë dërguar si më poshtë relacionet mbi vlerësimin e pasurive, me qëllim pasqyrimin e këtyre vlerave në regjistrin kontabël:

1. Shkresa nr.2715 prot., datë 20.03.2025
2. Shkresa nr. 5915 prot., datë 10.07.2024
3. Shkresa nr.4566 prot., datë 03.06.2024
4. Shkresa nr.1739 prot., datë 28.02.2024

Nga drejtoria e financës është hartuar regjistri i aktiveve për të gjitha aktivet që zotëron.

Rekomandimi është zbatuar.

11.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa që: Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve të vazhdojë procesin e certifikimit të pasurive publike, të cilat kanë kaluar në pronësi sipas VKM-ve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhër nr. 282 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve për zbatimin e rekomandimit.

Nga Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve, bazuar në Inventarin e Pronave të transferuara në pronësi të Bashkisë Kamëz, kryesisht me VKM-ve kanë vijuar procedurat ligjore për certifikimin e tyre.

Në total janë certifikuar 58 pasuri.

Pasuritë të cilat nuk janë certifikuar ende, kanë problematika të cilat lidhen kryesisht me:

1. Mosazhornimin e zonës dhe mungesën e hartave ku pozicionohen, proces i cili kryhet nga ASHK-ja.
2. Kalimi i pronësisë tek të tretët si rezultat i përfitimit të pronësisë sipas mënyrave të përcaktuara me ligj.
3. Zhvillimi urban i cili ka sjellë si pasojë investime të shumta në kanale kulluese që pas investimit janë kthyer në kolektorë, rrugë parcelash të cilat janë kthyer në rrugë urbane etj.

Grupi i Punës gjatë vitit 2024 ka punuar për përditësimin e inventarit, në kuadër të të cilit janë miratuar edhe VKB-përraktëse.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

12.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz të vijojë komunikimin ndër-institucional, për të adresuar çështjen e krijuar si pasojë e problematikës së evidentuar, pasi kjo e fundit bie brenda kuadrit administrativ dhe nuk mund të pengojnë zbatimin e kuadrit ligjor për funksionimin e institucionit të Bashkisë Kamëz.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhër nr. 282 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve për zbatimin e rekomandimit.

Për sipërfaqet pyjore të transferuara me VKM-në nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/bashkive”, i ndryshuar me VKM-në nr.684, datë 02.09.2020, ka përfunduar procesi i regjistrimit dhe certifikimit të tyre.

Konkretisht Bashkia Kamëz, pas përmbylljes së këtij procesi disponon dokumenta pronësie për pasuritë e llojit “Pyll” me sipërfaqe totale 1,540,290 m², si më poshtë:

1. Pasuria nr.1444/1, zk.1066, e llojit “Pyll”, me sipërfaqe 15302 m².
2. Pasuria nr.1444/2, zk.1066, e llojit “Pyll”, me sipërfaqe 213244 m².
3. Pasuria nr.1444/5, zk.1066, e llojit “Pyll”, me sipërfaqe 1311745 m².

Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave & Administrimit dhe Menaxhimit të Aseteve vazhdimisht ka kërkuar informacion mbi ecurinë e procesit të regjistrimit të sipërfaqeve pyjore, si nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës ashtu edhe nga Ministria e Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Palët kontraktuese (Ministria e Turizmit dhe CSI Piemonte & Datech) në lidhje me regjistrimin e sipërfaqeve pyjore në pronësi të bashkive, kanë përcaktuar në termat e referencës detyrimet dhe përgjegjësitë e zbatimit të kontratës. Nga Ministria e Turizmit është konfirmuar së produkti përfundimtar është depozituar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (shkresa nr.442/1 prot, datë 16.07.2021) me qëllim certifikimin e sipërfaqeve pyjore në pronësi të Bashkisë Kamëz.

Për përfundimin e procesit të certifikimit është mbajtur korrespondencë e vazhdueshme si me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve ashtu edhe me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës duke përfshirë shkresat e mëposhtme:

- Shkresa nr.5287/1., datë 12.02.2024, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së
- Shkresa nr.3357 prot., datë 27.02.2024, drejtuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Kamëz-Vorë
- Shkresa nr.2381/1 prot., datë 29.04.2024, drejtuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Kamëz-Vorë
- Shkresa nr.3419 prot., datë 30.04.2024, drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve
- Shkresa nr.6231 prot., datë 22.07.2024, drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore Kamëz-Vorë, Të ASHK-së.
- Shkresa nr.7018 prot., datë 21.08.2024, drejtuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Kamëz-Vorë
- Shkresa nr 9585 prot., datë 13.11.2024 drejtuar ASHK-së me të cilën është kryer procesi i aplikimit për paisjen me dokument pronësie të sipërfaqeve pyjore.

Rekomandimi është zbatuar.

13.1.Rekomandimi: Drejtoria Juridike, duhet të shqyrtojë përpara hartimit të kontratës, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të hartojë dispozitat e kontratës me referencë të saktë. Në përfundim të hartimit dhe nënshkrimit të kontratës, duhet të bashkëlidhi si aneks të kësaj të fundit, dokumentacionin e saktë, mbi të cilin është lidhur kontrata.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhër nr. 284 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik për zbatimin e rekomandimit, dhe do të mbahet në konsideratë në lidhjen e kontratave të qiradhënies në vijimësi. Për vitet 2024-2025 nuk ka kontrata të lidhura, kjo vërtetohet nga informacioni për kontratat e qiradhënies, bashkëlidhur.

Rekomandimi është i zbatuar.

B. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri në datën 31.12.2023, në vlerën totale 126,985,233 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se me urdhër nr. 278 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore për zbatimin e rekomandimit.

Spektori i Menaxhimit të Borxhit përmes Urdhërit të brëndshëm nr.1293/1 datë 04.02.2025 "Për saktësimin dhe masat administrative për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura" ka bërë saktësimin e debisë në vite duke rakorduar listën e debitorëve me sektorin e pagesave dhe sektorin e verifikimit në terren për një pasqyrim sa më real të listës së debitorëve. Sa më sipër janë marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKB-së nr. 120 datë 19.12.2024 "Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamez", ka ezauruar këto hallka procedurale për mbledhjen e detyrimeve të papaguara.

per subjektet debitorë, si më poshtë:

- Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
- Urdhëri i bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesve;

Konkretisht masat e marra paraqiten si më poshtë:

Për vitin 2025 nga debia e datës 31.12.2023 janë bllokuar 128 subjekte me nr. 6790/1 prot., datë 04.08.2025 dhe nr. 6790 datë 04.08.2025 nga Janari deri në Shtator janë arkëtuar 50 subjekte me vlerë 4,346,438, mbeten ende pa arkëtuar 458 subjekte me vlerë 109,625,317.

Me nr.4456 prot date 29.08.2025 jane bërë 1501 njoftime dhe Kërkesë për Pagesë

Rekomandimi është në proces zbatimi.

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kamëz, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale”, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë detyrimi 312,233,577 lekë ndaj 9,087 personave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se me urdhër nr. 281 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore për zbatimin e rekomandimit. Bashkia Kamëz me VKB nr. 86 datë 22.08.2024, mbi “Caktimin e U. K. K. Sh.A si agjent tatimor për mbledhjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje”, ka vendosur që struktura për vjeljen e kësaj takse është Agjenti Tatimor U. K. K..

Janë bërë akt-rakordimet mbi taksën e ndikimit në infrastrukturë mes DTTV-së dhe UKK-së për pagesat e kryera për TNI.

Akt- Rakordimi nr. 2948 prot datë 06.12.2024 U.s K. K. Sh.A dhe nr 10404 prot, datë 06.12.2024 Bashkia Kamëz për periudhën Shtator + Tetor 2024 me vlerë të arkëtuar 10,086,946 leke, për 310 persona.

Akt- Rakordimi nr. 43 prot. datë 09.01.2025 U.s K. K. Sh.A dhe nr. 278 prot, datë 10.01.2025 Bashkia Kamëz për periudhën Nëntor 2024, me vlerë të arkëtuar 9,232,720 lekë, për 274 persona.

Akt- Rakordimit nr.185 prot. datë 27.01.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 884 prot, datë 27.01.2025 Bashkia Kamëz për periudhën Dhjetor 2024, me vlerë 8,242,023 lekë, për 250 persona.

Akt- Rakordimit nr.1890 prot. datë 25.02.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 408 prot, datë 25.02.2025 Bashkia Kamëz për periudhën Janar 2025, me vlerë 6,961,393 lekë, për 187 persona.

Akt- Rakordimit nr.2851 prot. datë 28.03.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 629 prot, datë 28.03.2025 Bashkia Kamëz për periudhën Shkurt 2025, me vlerë 2,365,914 lekë, për 62 persona.

Akt- Rakordimit nr.3815 prot. datë 29.04.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 862 prot, datë 25.04.2025 Bashkia Kamëz për periudhën Mars 2025, me vlerë 1,860,495 lekë, për 52 persona.

Akt- Rakordimit nr.4299 prot, datë 20.05.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 1032 prot, datë 26.05.2025 Bashkia Kamëz për periudhën prill 2025, me vlerë 1,956,702 lekë, për 61 persona.

Akt- Rakordimit nr.5596 prot, datë 01.07.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 1279 prot, datë 24.06.2025 Bashkia Kamëz për periudhën maj 2025, me vlerë 1,159,391 lekë, për 40 persona.

Akt- Rakordimit nr.6521 prot, datë 25.07.2025 U. K. K. Sh.A për periudhën qershor 2025, me vlerë 3,877,656 lekë, për 88 persona.

Janë bërë edhe akt-rakordimet mbi taksën e ndikimit në infrastrukturë mes DTTV-së dhe UKK-së për pagesat e kryera për TNI.

Akt- Rakordimit nr.7472 prot. datë 02.09.2025 U. K. K. sh.a dhe nr. 1866 prot. datë 26.08.2025 Bashkia Kamëz për periudhën Korrik 2025, me vlerë 1,660,348 lekë, për 63 persona.

Akt- Rakordimit nr. 8631 prot. Datë 08.10.2025 U. K. K. sh.a dhe nr. 2103 prot. datë 24.09.2025 Bashkia Kamëz për periudhën Gusht 2025, me vlerë 2,564,488 për 59 persona.

Muaji	Vlera	Numër Persona
shtator tetor 2024	10,086,946	310
nentor 2024	9,232,720	274
dhjetor 2024	8,242,023	250
janar 2025	6,961,393	187
shkurt 2025	2,365,914	62
mars 2025	1,860,495	52
prill 2025	1,956,702	61

maj 2025	1,159,391	40
qershor 2025	3,862,656	87
korrik 2025	1,660,348	63
gusht 2025	2,564,488	59
Shuma	49,953,076	1,445
Total		
Njoftime te shperndara	312,233,577	9,087
Arketuar		5,400
Diferenca	49,953,076	1,445

Rekomandimi është në proces zbatimi.

3.1. Rekomandim: Bashkia Kamëz, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit sipas kontratave të qirasë në shumë **185,898 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhër nr. 284 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Çështjeve ligjore dhe Prokurimit Publik për zbatimin e rekomandimit. Janë llogaritur kamat vonesat dhe janë bërë njoftim detyrimet, dhe janë arkëtuar vlerat me faturat përkatëse. Bazuar në raportet 6-mujore të monitorimit grupi i punës ka konstatuar edhe vonesat në likuidim.

-Nga verifikimi rezulton se gjatë vitit 2024, subjektit "P. S." PF, ka paguar vlerën e detyrimit te prapambetur 163,860 lekë në datë 16.01.2024, si dhe vlerën e kamatvonesës 13,218 lekë për vitin 2023, në datë 17.05.2024, gjithashtu OE "G." SHPK ka shlyer detyrimin në shumën 8,820 lekë, në datë 03.06.2024, e vërtetuar kjo me regjistrimet në ditarin e të ardhurave të rakorduara me degën e thesarit Tiranë. Ndërkohë OE "B." SHPK është ende në proces gjyqësor.

Rekomandimi është zbatuar.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe me strukturat e tjera, që në aktivitetin e tyre sigurojnë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, të analizojnë situatën debitorë dhe të hartojnë një plan masash periodik dhe vjetorë:

- Për të siguruar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore brenda afateve të miratuar me VKB, me qëllim parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj;
- Për rritjen e arkëtimeve nga ana e debitorëve me qëllim minimizimin e vlerës progresive të debisë prej 929,858,495 lekë, për 41,254 debitorë familjarë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se me urdhër nr. 278 prot., datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore për zbatimin e rekomandimit.

Nga DTTV/Sektori i Taksave Familjare janë marrë masa konkrete për arkëtimin e debisë së konstatuar, si më poshtë:

- Është evidentuar lista e debitorëve për vitin 2024
- Janë bërë njoftim-detyrimet për të gjithë abonentët nga sistemi i DTTV
- Kërkesë për bashkëpunim Njësive Administrative dhe Lagjeve të Bashkisë Kamëz ku në bashkëpunim me Ndërlidhësit me Komitetin janë njoftuar familjet në lidhje me detyrimet e prapambetura.

- Njoftime me anë të telefonateve nga specialistët në njësitë përkatëse
- Njoftim për likuidim detyrimesh drejtuar Drejtorive të Bashkisë Kamëz në lidhje me likuidimin vullnetar të detyrimit të taksave dhe tarifave vendore familjare nga ana e punonjësve.
- Bashkëpunim me Drejtorinë e Strehimit dhe Emergjencave Civile dhe Njesinë Administrative Paskuqan lidhur me saktësimin dhe përjashtimin nga detyrimi për vitin 2025 për familjet që janë prekur nga ndërtimi i Unazës së Madhe Tiranë dhe ndërtimet në Liqenin e Paskuqanit, pasqyruar në Paketën Fiskale për vitin 2025.
- Në bazë të ligjit Nr. 10 418, datë 21.04.2011 (Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjesë të borxhit tatimor dhe doganor) është bërë i mundur evidentimi i 7571 familjeve Debitore në vlerë 39,305,000 lekë.
- Njoftim për likuidim detyrimesh drejtuar Drejtorive të Bashkisë Kamëz dt.26.12.2024 në lidhje me likuidimin vullnetar të detyrimit të taksave dhe tarifave vendore familjare nga ana e punonjësve.
- Njoftim dhe kërkesë për të paguar detyrimin e Vitit 2024
Janë bërë 1000 njoftime me nr prot 10145-10145/999, datë 06.12.2024.
- Njoftim dhe kërkesë për të paguar detyrimin e Vitit 2024
Janë bërë 464 njoftime me nr prot 4015- 4015/463 date 17.07.2025
- Njoftim për likuidim detyrimesh drejtuar Drejtorive të Bashkisë Kamëz në lidhje me likuidimin vullnetar të detyrimit të taksave dhe tarifave vendore familjare nga ana e punonjësve me Nr.4783 prot, datë 05.06.2025.

Pagesat 01.01.2024-31.12.2024

Janë arkëtuar total 126,012,309 lekë, nga ku debi është 9,636,753 dhe pagese e vitit 2024 është 116,375,556 lekë. Nga verifikimet që janë bërë nga Sektori i Taksave Familjare mbi saktësinë e listës së debitorëve ndër vite, janë identifikuar një sërë problematikash dhe është saktësuar numri i debitorëve dhe vlera e detyrimeve të mbartura, sipas tabelës së mëposhtme:

Problematika	Nr	Vlerë
Ligji Nr. 10 418, datë 21.04.2011	7,571	39,305,000
Dublikatë	586	4,062,900
Faturim në UKK dhe DTTV (dublime)	1,095	13,117,650
Sistemim të dhenash	2,336	37,630,470
Total	11,588	94,116,020

Në lidhje me taksat familjare ju informojmë për masat shtesë që janë marrë:

- Janë bërë 560 njoftime me nr. prot 4080- 4080/559 datë 29.07.2025
 - Janë bërë 1146 njoftime me nr. prot 4275- 4275/1145 datë 31.07.2025
 - Janë bërë 199 njoftime me nr. prot 4624- 4624/198 datë 18.09.2025
- 1- Në datat 11.08.2025-26.09.2025 u ngritën 17 grupe pune për punonjësit e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të cilët bënë njoftimin në terren të qytetarëve për debinë e prapambartur të taksës familjare.
 - 2- Të dhënat e përmbledhura janë si më poshtë:

Data	Nr. Prot	Grupe pune	Punonjës	Zona
11.08.2025-18.08.2025	4328-4332	5	15	Bathore
18.08.2025-25.08.2025	4361-4365	5	16	Bathore
25.08.2025-31.08.2025	4422-4425	3	9	Bathore
18.09.2025-26.09.2025	4620-4621	2	4	Valias
24.09.2025-26.09.2025	4632-4633	2	6	Valias

Grupet e Punës

Njoftime në terren

Banon në qytet tjetër	26
Sistemim Debie	39
Me kontratë uji	52
Ka ndërruar jetë	7
U informua	379
Emigrant	377

Nuk ndodhen në adresë	392
Total	1272

3- Pagesat 01.01.2025-31.08.2025

Janë arkëtuar nga DTTV në total 10,856,741 lekë, nga ku 8,335,970 lekë është pagesë debie e viteve të mëparshme dhe 2,520,771 lekë është pagesa e vitit 2025.

Janë arkëtuar nga Agjenti Tatimor Ujësjetllës Kanalizime Kamëz në total 74,506,584.39 lekë, nga ku 72,643,919.78 lekë i takojnë Bashkisë Kamëz dhe pjesa tjetër UKK në vlerën prej 1,862,664.61 leke si komision.

Nga verifikimet që janë bërë nga sektori i taksave familjare për vlerën reale të debisë deri tani kemi identifikuar vlerën e debisë sipas tabelës së mëposhtme:

Debi 2011-2024

	Total	
	Nr	Vlerë
Dublikat	587	4,050,900
Ligjit 10 418 datë 21.04.2011	7501	39,305,000
Sistemim debie	10343	65,697,070
Debi Aktuale	27,656	820,805,525

4- Shkresat për saktësimin e Debisë

- Shkresa nr 1447/1 prot, datë 02.09.2025 për kategoritë përfituese për taksën familjare (emigrantet dhe personat që rrjedhin nga një trung familjar) nga Lagja administrative nr 2.
- Shkresa nr 1599/1prot. datë 20.08.2025 për kategoritë përfituese për taksën familjare (emigrantet dhe personat që rrjedhin nga një trung familjar) nga Njësia Administrative Paskuqan.
- Kthim përgjigje në adresën elektronike email datë 07.07.2025 dhe 10.07.2025 nga gjendja civile për konfirmim të kryefamiljarëve që nuk janë kryefamiljar në vitin 2025, por që rezultojnë debitorë.

Po punohet për saktësimin e Debisë: mbi personat që nuk rezultojnë me leje banini në Bashkinë Kamëz, personat që kanë ndërruar jetë, familjet e reja, identifikimin e familjeve të cilët anetarët e tyre kanë kontratë uji, si edhe me përpilimin e listës përfundimtare me debitë përkatëse.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se me urdhër nr. 280 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e rekomandimit.*

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve në buxhetin e vitit 2024 dhe 2025, janë trajtuar me prioritet detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Vlera e detyrimeve të prapambetura është ulur nga viti në vit. Sipas librave të kontabilitetit vlera e detyrimeve të prapambetura paraqitet:

me datë 31.12.2022 vlera është 210,762,579 lekë,

me datë 31.12.2023 vlera është 137,904,870 lekë,

më datë 31.12.2024 vlera është 71,825,748 lekë,

me datë 31.03.2025 vlera është 70,555,043 lekë,

Rekomandimi është zbatuar.

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Licencave dhe e Transportit, Bashkia Kamëz, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 2,424,000 lekë për 12 subjekte të cilave u është rinovuar autorizimi gjatë vitit 2023 dhe njoftimin e 17 subjekteve për debinë e konstatuar në shumën 13,600,000 lekë dhe fillimin e procedurës së arkëtitimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhër nr. 283 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Licencave dhe Transportit për zbatimin e rekomandimit.*

Bashkia Kamëz ka ndërmarrë masa për arkëtimin e vlerave në vazhdimësi për paisjen me autorizim për periudhën 2022-2025 për këto subjekte si vijon:

Vlera Fillestare	Arketuar 2022	Arketuar 2023	Arketuar 2024	Arketuar 2025	Vlera Mbetur
13,600,000	2,000,000	400,000	2,800,000	6,000,000	2,400,000
13,600,000	2,000,000	400,000	2,800,000	6,000,000	2,400,000

Gjithashtu jemi në procesin e arkëtitimit total deri në fund të vitit të shumë së detyrimit 13,600,000 lekë që ju takon këtyre subjekteve për ushtrimin e aktivitetit të tragtimin me pakicë të karburanteve për periudhën 2022-2025.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e Licencave dhe e Transportit, Bashkia Kamëz, të njoftojë Inspektoratin Shtetëror, për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhër nr. 283 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Licencave dhe Transportit për zbatimin e rekomandimit.*

Më urdhër nr. 1595 prot, datë 13.02.2025 janë ngritur grupet e punës për evidentimin, njoftimin dhe bllokimin e aktivitetit të subjekteve që tregtojnë me pakicë karburante dhe derivatet e tyre. Me nxjerrjen e këtij urdhëri, pas njoftimit paraprak, subjektet kanë aplikuar për për pajisjen me autorizim dhe janë paisur me 12 subjekte me autorizim, bashkëngjitur lista përkatëse nga Drejtoria e Licensimit dhe transportit.

-Për 2 subjektet pa autorizim "Sh. K." me Nipt L..S dhe "K. M." me Nipt M..M, është dërguar shkresa ISHT-it me nr. 6538 Prot. datë 28.07.2025 Njoftimi ISHT-it si masë shteruese bazuar në ligj është në proces pasi jemi në kontaktet e fundit me këto subjekte për paisjen e tyre me autorizim tregti shitje karburanti dhe derivateve të tyre.

Rekomandimi është zbatuar.

D. MASA DISIPLINORE

D. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kamëz, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a -"Vërejtje" neni 58 shkronja (a), për 4 punonjës si më poshtë:

1. Z. E. B. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për mangësitë e mëposhtme:

Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” i ndryshuar.

2. Znj. G. D. në cilësinë e përgjegjëses së sektorit të terrenit.

Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” i ndryshuar.

3. Znj. L. K. në cilësinë e përgjegjëses së sektorit të vlerësimit të detyrimit dhe menaxhimit të borxhit.

Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” i ndryshuar.

4. Z. E. S. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të taksave familjare.

Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” i ndryshuar.

5. Z. Sh. L. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Licencave dhe Transportit.

Për mos zbatimin e kërkesave të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015.

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit:

Me urdhër nr. 286 prot, datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore për zbatimin e rekomandimit.

-Me Vendimin nr. 343, datë 28.05.2025 “Për dhënien masë disiplinore”, është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për nëpunësin Z. E. B. me detyrë, ish-Drejtor pranë Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore.

-Znj. G.D. është me leje lindje dhe nuk mund ti jepet masë disiplinore.

-Me Vendimin nr. 4523, datë 28.05.2025 “Për dhënien masë disiplinore”, është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për nëpunësin Z. E.S. me detyrë, ish-Pergj. Sektori pranë Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore.

-Znj. L. K. është larguar nga detyra Drejtore i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore me Urdhër nr. 550, datë 07.06.2024.

-Me Vendimin nr. 4519 prot, datë 27.05.2025 “Për dhënien masë disiplinore”, është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmerim për largim nga puna” për nëpunësin Z. Sh. L. me detyrë, ish-Drejtor, të Drejtorisë së Licencave dhe Transportit.

Rekomandimi është zbatuar.

D. 2. Për punonjësit e larguar:

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

1. Z. G. M. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Kadastrës, Bordit të Kullimit dhe Menaxhimit të Aseteve. Për mos zbatimin e kërkesave të VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014

“Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

E. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Kamëz, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecursë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

- Me shkresën me nr. 4758 prot., datë 04.06.2025, Bashkia Kamëz, Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka njoftuar Departamentin e Administratës Publike, për masat disiplinore të vendosura në bazë të rekomandimeve të KLSH.

- Me shkresën me nr. 4758 prot., datë 04.06.2025, Bashkia Kamëz, Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka njoftuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për masat disiplinore të vendosura në bazë të rekomandimeve të KLSH.

II- Programi i Auditimit nr. 1370 prot., datë 13.11.2024- Zbatimi i rekomandimeve

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin në Bashkinë Kamëz sipas programit të Auditimit nr. 1370 prot., datë 13.11.2024- Zbatimi i rekomandimeve, dërguar me shkresën nr. 1370/48 prot., datë 08.04.2025.

A. MASA ORGANIZATIVE

22.1. Rekomandimi: Drejtoria e TTV Bashkia Kamëz, të marrë të gjitha masat administrative e ligjore për planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave për tarifa vendore (tarifë pastrimi, tarifë gjelbërimi, tarifë ndriçimi) për të gjitha subjektet e ndërtimit që marrin leje ndërtimi nga bashkia (për çdo kantier ndërtimi).

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me urdhër nr. 294 prot. datë 17.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore për zbatimin e rekomandimit.

Spektori i terrenit në bashkëpunim me spektorin e vlerësimit dhe regjistrimit ka rakorduar në vazhdimësi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit për lejet e ndërtimit të dhëna të Bashkinë Kamëz.

Nga shkëmbimi i informacionit mes dy drejtorive sipas shkresës nr.9932 datë 25.11.2024, e azhurnuar sipas email dhe të dhënave përfundimtare për vitin 2024 më datën 19.02.2025 nga të dhënat e marra nga DPZHT, Spektori i terrenit pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore ka kryer planifikimin e të ardhurave për vitin 2025 dhe debinë për të gjitha lejet e dhëna në vitin 2024 nga DPZHT.

Dhe sipas informacionit i protokolluar pranë DTTV me nr.502 prot datë 05.03.2025 u krye planifikimi sipas paketës fiskale nr.120 datë 19.12.2024, për 185 leje të dhëna në vitin 2024, dhe me vlerë të planifikuar 25,392,500 lekë.

Gjatë vitit 2025 për subjektet ndërtuese që janë të pajisur me leje ndërtimi është ndjekur procedura për arkëtimin e të ardhurave. Faturat janë të ngarkuar në sistemin online të DTTV, ku cdo subjekt mund ta marrë faturën në

kohë reale, janë dërguar njoftim kërkesat për pagesë në mënyrë shkresore dhe me email sipas procedurave tatimore.

Për vitin 2025 sipas shkresës nr.5889 prot datë 08.07.2025 DTTV ka kërkuar informacion për lejet e dhëna nga DPZHT për vitin 2025. Proces që do i hap rrugë planifikimit të të ardhurave nga lejet e ndërtimit të dhëna në vitin 2025.

Janë marrë masat për planifikim dhe arkëtim (per periudhën janar-dhjetor 2024 është arkëtuar vlera prej 23,538,688 lekë, për periudhën janar -qërshor 2025 është arkëtuar vlera 11,711,868 lekë).

Për subjektin A. C. SHPK me Nipt L...R është marë vendim nga Komisioni i Apelimit Tatimor DTTV datë 07.02.2025 Vendimi nr.2331 prot. ku është vendos të njihet dokumentacioni vërtetues për mbyllje punimesh për 18 leje ndërtimi për vitin 2022 dhe sipas diferencave të përlllogaritura detyrimi i mbetur për lejet e vitit 2022 është 729,154. Subjekti ka shlyer të gjith detyrimin (dokumentat bashkelidhur).

-Për subjektin F.2. SHPK me Nipt L...A është marë vendim nga Komisioni i Apelimit Tatimor DTTV datë 03.06.2025 Vendimi nr.4746 prot. ku është vendos të njihet dokumentacioni vërtetues për mbyllje punimesh për lejet e ndërtimit për vitin 2022 dhe sipas diferencave të përlllogaritura detyrimi i mbetur për lejet e vitit 2022 do të jetë 693,667 lekë. Subjekti është njoftuar për detyrimin dhe ka lidhur Akt – marrëveshje pranë DTTV- së me datë 14.07.2025 me nr. 3952 prot për likuidim me këste të detyrimit i cili ka shlyer dy këste të detyrimit me vlerë 277,466 (dokumentat bashkelidhur). Vlera e mbetur pa arkëtuar 416,201 lekë.

-Për subjektin D. K. me Nipt L...L pas sistemit përkatës sipas legjislacionit në fuqi ka shlyer të gjithë detyrimin e takuar me vlerë 1,130,000 (dokumentat bashkelidhur).

- Për subjektin K.L. me Nipt L...V i është bërë rillogaritja dhe sistemi përkatës dhe sipas diferencave të përlllogaritura detyrimi i mbetur për lejet e vitit 2022 është me vlerë 1,952,834. Subjekti është njoftuar për detyrimin dhe ka lidhur Akt – marrëveshje pranë DTTV- së me datë 08.10.2025 me nr. 4668 prot., për likuidim me këste të detyrimit i cili ka shlyer 20% te detyrimit me vlerë 390,566.80 (dokumentat bashkelidhur).

Rekomandimi është në proces zbatimi.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të ushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërin e punës “Bojë bikomponente (pastë) për kalim këmbësorësh me ngjyrë të kuqe dhe shirita të bardhë sipas detajit” dhe t’i kërkojë realizimin sipas specifikimeve teknike, në vlerë **504,000 lekë** sipërmarrësit të punimeve nga BOE “N.” SHPK & “B.” SHPK, në objekt brenda periudhës së garancisë se defekteve, para datës 10.01.2025 parashikuar në kontratën e sipërmarrjes së punimeve nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Operatori Ekonomik fitues. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas projektit të zbatimit (PZ) dhe specifikimeve teknike për vijëzimet e këmbësorëve, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve BOE “N.” SHPK & “B.” SHPK, ku Bashkia Kamëz të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se vlera prej 504,000 lekë është arkëtuar me urdhër shpenzimin nr.150 datë 04.02.2025.

Rekomandimi është zbatuar.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërin e punës “Zëri 2 (An-142) Bojë antirrëshkitëse 2 mm me ngjyrë” dhe t’i kërkojë realizimin sipas specifikimeve teknike, në vlerë 120,000 lekë sipërmarrësit të punimeve nga OE “E.” SHPK, në objekt brenda periudhës së garancisë se defekteve, para datës 05.06.2025 parashikuar në kontratën e sipërmarrjes së punimeve nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Operatori Ekonomik fitues. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas projektit të zbatimit (PZ) dhe specifikimeve

teknike për vijëzimet e këmbësorëve, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve OE “E.” SHPK, ku Bashkia Kamëz të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se vlera prej 120,000 lekë është arkëtuar me urdhër shpenzimin nr.154, datë 04.02.2025.*

Rekomandimi është zbatuar.

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërin e punës “Vizime me bojë bikomponentë pastë për këmbësorë (Rruga Albanët, Valias i Ri; Ndërtim kunete dhe trotuare nga 1 anë + ndriçimi i rrugës “Amsterdam Kamëz)” sipas specifikimeve teknike, në vlerë **216,000 lekë** sipërmarrësit të punimeve nga OE “N.” SHPK, në objekt brenda periudhës së garancisë se defekteve, para datës 12.07.2025 parashikuar në kontratën e sipërmarrjes së punimeve nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Operatori Ekonomik fitues. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas projektit të zbatimit (PZ) dhe specifikimeve teknike për vijëzimet e këmbësorëve, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve OE “N.” SHPK, ku Bashkia Kamëz të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, vlera prej 216,000 lekë është arkëtuar më datë 11.04.2025 në Raiffeisen Bank (vërtetuar me mandatin bankar)*

Rekomandimi është zbatuar.

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET E PRAPAMBETURA NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

2.1 Rekomandimi: Bashkia Kamëz, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **297,508,794 lekë** ndaj **8,608** personave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se me urdhër nr. 281 prot. datë 09.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore për zbatimin e rekomandimit. Bashkia Kamëz me VKB nr. 86 datë 22.08.2024, mbi “Caktimin e U. K. K. Sh.A si agjent tatimor për mbledhjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje”, ka vendosur që struktura për vjeljen e kësaj takse është Agjenti Tatimor U. K. K. Sh.A.*

Janë bërë akt-rakordimet mbi taksën e ndikimit në infrastrukturë mes DTTV-së dhe UKK-së për pagesat e kryera për TNI. Akt- Rakordimi nr. 2948 prot datë 06.12.2024 U. K. K. Sh.A dhe nr 10404 prot, datë 06.12.2024 Bashkia Kamëz për periudhën Shtator + Tetor 2024 me vlerë të arkëtuar 10,086,946 leke, për 310 persona.

Akt- Rakordimi nr. 43 prot. datë 09.01.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 278 prot, datë 10.01.2025 Bashkia Kamëz për periudhën Nëntor 2024, me vlerë të arkëtuar 9,232,720 lekë, për 274 persona.

Akt- Rakordimi nr.185 prot. datë 27.01.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 884 prot, datë 27.01.2025 Bashkia Kamëz për periudhën Dhjetor 2024, me vlerë 8,242,023 lekë, për 250 persona.

Akt- Rakordimit nr.1890 prot. datë 25.02.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 408 prot, datë 25.02.2025 Bashkia Kamëz për periudhën Janar 2025, me vlerë 6,961,393 lekë, për 187 persona.

Akt- Rakordimit nr.2851 prot. datë 28.03.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 629 prot, datë 28.03.2025 Bashkia Kamëz për periudhën Shkurt 2025, me vlerë 2,365,914 lekë, për 62 persona.

Akt- Rakordimit nr.3815 prot. datë 29.04.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 862 prot, datë 25.04.2025 Bashkia Kamëz për periudhën Mars 2025, me vlerë 1,860,495 lekë, për 52 persona.

Akt- Rakordimit nr.4299 prot, datë 20.05.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 1032 prot, datë 26.05.2025 Bashkia Kamëz për periudhën prill 2025, me vlerë 1,956,702 lekë, për 61 persona.

Akt- Rakordimit nr.5596 prot, datë 01.07.2025 U. K. K. Sh.A dhe nr. 1279 prot, datë 24.06.2025 Bashkia Kamëz për periudhën maj 2025, me vlerë 1,159,391 lekë, për 40 persona.

Akt- Rakordimit nr.6521 prot, datë 25.07.2025 U. K. K. Sh.A për periudhën qershor 2025, me vlerë 3,877,656 lekë, për 88 persona.

Pra gjithsej për muajt shtator 2024- qershor 2025 është arkëtuar vlere 45,743,240 leke, nga 13 persona. Janë njoftuar 3,753 persona dhe kanë tërhequr faturat për arkëtim 1504 persona. Nga agjenti tatimor vazhdon shpërndarja e njoftim detyrimeve.

Muaji	Vlera	Numër Persona
Shtator tetor 2024	10,086,946	310
Nëntor 2024	9,232,720	274
Dhjetor 2024	8,242,023	250
Janar 2025	6,961,393	187
Shkurt 2025	2,365,914	62
Mars 2025	1,860,495	52
Prill 2025	1,956,702	61
Maj 2025	1,159,391	40
Qershor 2025	3,877,656	88
Shuma	45,743,240	1,324
Total	312,233,577	9,087
Njoftime të shpërndara		3,753
Arkëtuar	45,743,240	1,324
Diferenca	266,490,337	7,763

Rekomandimi është në proces zbatimi.

6.1.Rekomandimi: Bashkia Kamëz, Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, të marrë masa për saktësimin e regjistrave në përputhje me gjendjen faktike të tokës bujqësore, kontabilizimin e detyrimeve dhe marrjen e masave duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara taksa e tokës bujqësore në total në vlerën 56,704,963 lekë duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se: Me urdhër nr. 296 prot. datë 17.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Kadastrës për zbatimin e rekomandimit.

Është ngritur Grup Pune “Për saktësimin e sipërfaqes së tokës arë dhe pasqyrimin e ndryshimeve në bazën e të dhënave të taksës së tokës bujqësore”, i cili po punon në vijimësi për përditësimin e bazës së të dhënave mbi taksën e tokës bujqësore.

Grupi i Punës ka realizuar deri tani detyrat e mëposhtme:

- Janë hedhur nga e para në një bazë të re të dhënash përfituesit e tokës bujqësore sipas ligjit nr.7501 “Për tokën”. Aktualisht jemi në proces të vazhdueshëm analizimi dhe krahasimi të këtij informacioni me listën ekzistuese.
- Në bashkëpunim me zyrën e gjendjes civile dhe ndërlidhësve me komunitetin, janë identifikuar adresat për një pjesë të subjekteve debitore të taksës së tokës bujqësore dhe është bërë njoftimi i tyre mbi vlerën e debisë. Saktësimi i adresave për pjesën tjetër të subjekteve debitore po përditësohet në vijimësi.
- Janë identifikuar raste të vetëdeklarimit që nuk disponojnë tokë bujqësore të pasqyruara në tabelën ekzistuese të taksës së tokës bujqësore. Për të gjitha këto raste po kryhen verifikimet e nevojshme për të konstatuar vërtetësinë e tyre.

- Janë saktësuar nga depozitimi i kontratave nëpërmjet të cilave janë kryer transaksione me tokën bujqësore rastet e pasqyruara në tabelën ekzistuese të taksës së tokës bujqësore. Ky proces po kryhet në vijimësi.
 - Janë identifikuar raste të dublikimeve të pasqyruara në tabelën ekzistuese të taksës së tokës bujqësore dhe po punojmë për pasqyrimin e tyre në bazën e re të të dhënave.
 - Janë pasqyruar ndryshimet e ndodhura në tokën bujqësore si pasojë e kthimit të saj në tokë truall, sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit si dhe dokumentacionit të depozituar nga qytetarët. Lejet e ndërtimit të dhëna nga kjo drejtori po pasyrohen në mënyrë të vazhdueshme në bazën e të dhënave duke kryer ndryshimet përkatëse si në sipërfaqe ashtu edhe në vlerën e debisë.
 - Janë pasqyruar ndryshimet e ndodhura në tokën bujqësore si pasojë e kthimit të saj në tokë truall, sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit si dhe dokumentacionit të depozituar nga qytetarët. Lejet e ndërtimit të dhëna nga kjo drejtori po pasyrohen në mënyrë të vazhdueshme në bazën e të dhënave duke kryer ndryshimet përkatëse si në sipërfaqe ashtu edhe në vlerën e debisë.
- Përditësimi i listës së debitorëve të taksës së tokës bujqësore është në proces. Në përfundim të këtij procesi do të përcillet nga drejtoria jonë pranë Drejtorisë së Financës, lista e debitorëve të taksës së tokës bujqësore me qëllim paraqitjen e debisë sipas gjendjes aktuale në pasqyrat financiare.
- Më poshtë po ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur me shifra konkrete, veprimet e mësipërme:
- Në bashkëpunim me zyrën e gjendjes civile dhe ndërlidhësve me komunitetin, është bërë e mundur gjetja e adresave për një pjesë të subjekteve debitoare të taksës së tokës bujqësore dhe janë njoftuar nëpërmjet postës mbi detyrimin përkatës.

Numri i njoftim detyrimeve	418
----------------------------	-----

Pas marrjes së Njoftim-Detyrimeve, janë konstatuar raste të subjekteve që nuk kanë disponuar asnjëherë tokë bujqësore në territorin e Bashkisë Kamëz, por që si rezultat gabimeve materiale gjatë hartimit të tabelës së taksës, rezultojnë si debitorë në tabelën aktuale si dhe rasteve të subjekteve që kanë kryer transaksione me tokën bujqësore dhe nuk disponojnë aktualisht sipërfaqen sipas tabelës së taksës së tokës bujqësore.

Raste vetëdeklarimi që nuk disponojnë tokë bujqësore

Raste vetëdeklarimi	Sipërfaqe e saktësuar/m ²
8	4,5470

1. Janë identifikuar të gjitha rastet e dublikimeve të pasqyruara në tabelën ekzistuese të taksës së tokës bujqësore duke sjellë ndryshime në debi dhe sipërfaqe të tokës bujqësore si më poshtë:

Numri i dublikimeve	Sipërfaqe e saktësuar/m ²
124	249,355

2. Janë pasqyruar ndryshimet e ndodhura në tokën bujqësore (kthimi i saj në tokë truall) si rezultat i lejeve të ndërtimit të dhëna nga Bashkia Kamëz, për vitet 2020-2024, sipas tabelës së mëposhtme:

Leje ndërtimi (2020-2024)	Sipërfaqe e saktësuar/m ²
56	56,654

3. Nga informacionet e marra janë verifikuar dhe plotësuar me të dhëna adresës, ID-së dhe numrit të kontaktit, subjektet e mëposhtëm:

Emërtimi	Numri total i Subjekteve	Subjekte të plotësuara me të dhënat
Numri	6681	2689

Gjatë vitit 2024 janë arkëtuar 5,744,762 lekë nga taksa e tokës bujqësore

Gjatë vitit 2025 (gjashtë mujori i parë) janë arkëtuar 3,162,902 lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

7.3. Rekomandimi: Drejtoria e Transportit Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrimit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara në **vlerën totale 7,458,666 lekë.**

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se, me urdhër nr. 295 prot. datë 17.04.2025 është ngarkuar Drejtoria e Transportit Lejeve e Licencave për zbatimin e rekomandimit. Me urdhërin nr 09 datë 10.01.2024 është ngritur grupi punës për marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura tatimore.

-Me shkresën nr 4215/1 prot, datë 07.06.2024, Drejtoria e Transportit Lejeve dhe Licencave drejtuar DTTV, ka kërkuar që në vijimësi kerkesat për informacion nga subjektet per gjendjen e tyre debitore (sic jane kerkesat per vertetime apo kerkeset per informacion nga QKB apo te tjere) nuk duhet ti jepet si sherbim pa shlyer detyrimin e DLT si dhe ju jane derguar njoftim detyrimet dhe kerkesat per pagese subjekteve debitore.

Në zbatim të masave të marra nga kjo Drejtori është arkëtuar vlera prej 4,920,000 lekë (66%).

Ngelur në proces arketimi vlera 2,538,666 lekë (kryesisht subjekte të mbyllura)

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT